AGJËRIMI ËSHTË MBUROJË..!

BESA DHE MALLI I HAXHI VEHBI GAVOÇIT

AGJËRIMI DHE IMUNITETI I TRUPIT

UDHA ISLAME

Botim i Myftinisë Shkodër
E përmuajshme
Informative - Fetare
Kulturore - Edukative

Viti 18 - Nr. 4 (206), Prill, 2020

www.myftinia-shkoder.org

MYFTINIASHKODER1990

Me zemër të mirë Muajin e Ramazanit!

RAMAZANI është muaj
i pendimit dhe i faljes,
i bindjes dhe i mirësisë,
MUAJ I PËRKUSHTIMIT...

UDHËZIMI DHE DRITA E ZOTIT NA NDRIÇOFSHIN JETËN!

(Mesazh urimi për komunitetet e krishtera të Shkodrës, në kushtet e pamundësisë së zhvillimit të vizitave dhe urimeve tradicionale, për shkak të rregullave të imponuara nga e quajtura pandemi covid 19)

Zoti i gjithësisë desht për ne që të jetojmë së bashku në këtë nënqiell të këtij qyteti të begatë, plot mirësi e bekim, duke marrë e dhënë në harmoni me vlerat tona fetare, qytetare e kombëtare, në përpjekje të vazhdueshme për të ruajtur ekuilibrin e natyrës dhe dritën e paqes, si dëshmitar të tyre, si përhapës e mbrojtës me dinjitet të një obligimi të shenjtë, që buron nga Fjala e Zotit të gjithësisë... (f.17)

ADHURIMET NË RAMAZAN

"Në Sheriatin islam nuk ka asnjë dispozitë të vetme që të mos ketë kuptim dhe urtësi. E kupton, kush e kupton dhe nuk e kupton ai që nuk e kupton.

Prej këtyre kuptimeve dhe urtësive për shembull është abdesi. Përse ne kur marrim abdes, lajmë disa pjesë të veçanta të trupit? Ose, falja e namazit me lëvizjet e tij, kur falim namazin... (f.6)

BAMIRËSIA NË RAMAZAN

Të parët tanë të mirë janë shembulli më i mirë për ne, me bujarinë dhe me bamirësinë e tyre. Për shembull, Enes ibn Sirin, çdo natë gjatë Ramazanit i ushqente pesëqind njerëz.

"Veprat e bamirësisë përsosen me tri cilësi: ta japësh atë sa më shpejt, ta shikosh si të vogël atë që jep, dhe ta japësh fshehurazi"... (f.14)

MESAZHI I MYFTIUT TË SHKODRËS, ME RASTIN E NATËS SË GJYSMËS SË SHABANIT 1441/2020

Imam Muhamed Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

Nata e Gjysmës së Shabanit është një moment, ku All-llahu i Madhëruar me mëshirën e Tij vështron krijesat e Tij, duke dhuruar bekime e falje, mëshirë e shpresë!

Imam Ahmedi transmeton nga sahabiu Abdull-llah ibn Amr (r.a.), nga i Dërguari i All-llahut (xh.sh.), i cili thotë: "All-llahu i Madhëruar vështron drejt krijesave të Tij, Natën e Gjysmës së Shabanit dhe i fal krijesat e Tij, përveç dy lloje njerëzish: ngatërrestarin dhe vrasësin!".

Është një kohë për të thirrur veten drejt pendimit dhe kërkimit falje, drejt ndreqjes së gabimeve dhe heqjes dorë nga vese e devijime në sjelljen dhe komunikimin tonë, që na largojnë nga dyert e dashnisë së Krijuesit Mëshirëplotë!

Është një kohë për të shuar hasmëritë, për t'u paqtuar, për të sosur armiqësitë e ngatërresat e kota, që mbajnë njerëzit (në shumë raste edhe pjestarë të një familje a farefisi, larg e në grindje me njëri-tjetrin) në distanca zemërimi e mungesë komunikimi!

All-llahu i Madhëruar dëshiron që ne të jetojmë në harmoni me vlerat tona, në paqe e komunikim të vazhdueshëm, duke dhuruar mirësi e mëshirë, për të përfituar mirësi e mëshirë nga Dhuruesi dhe Poseduesi i tyre i vërtetë!

Nata e Gjysmës së Shabanit të këtij viti është një moment i mirë edhe për t'u lutur që Zoti i gjithësisë ta bëjë hajr këtë situatë që po kalon njerëzimi, të na mbulojë me mëshirë e butësi, e të na ruajë nga e keqja e kësaj gjendjeje që ka futur njerëzinë në vështirësi e ankth!

Është koha për të vërtetuar nëpërmjet lutjeve tona drejtuar Zotit të botëve se, ne si besimtarë, me disiplinimin tonë fetar, qëndrojmë në shkallën e dorëzimit para vullnetit të Zotit, por assesi të përfshirë në propagandat e panikut, tmerrit e hutimit, që po përhapen sot, gjithandej nëpër botë!

Ne jemi të thirrur të jetojmë me dinjitet, të përballemi me sprovat me dinjitet, të komunikojmë me dinjitet dhe të mos pranojmë çdo thirrje e propagandë, nga kushdo qoftë e sido qoftë, pa e kaluar në filtrat e mendimit të ekuilibruar, arsyetimit të shëndoshë dhe argumenteve bindëse!

Ne nuk i dijmë hajret e sprovave dhe mbi të gjitha ne besojmë fort se çdo gjë në këtë botë ndodh me dijen e Zotit të Plotfuqishëm. Njëkohësisht, ky është momenti që të lutemi që All-llahu i Madhëruar të na udhëzojë drejt përmirësimit dhe rinisjes së një marrëdhënieje të re me Madhninë e Tij, me njëri-tjetrin, me familjen, me të afërmit, me mënyrën e perceptimit të së mirës dhe të keqes në jetë, në mënyrë që të përfitojmë nga ndodhitë e ditëve dhe të rritemi!

Transmeton Imam Tabaraniu dhe Ibn Hibbani në Sahihun e tij, nga Hz. Muadh ibn Xhebel (r.a.), se Resulull-llahu (a.s.) ka thënë: "All-llahu i Madhëruar vështron krejt krijesat e Tij në Natën e Gjysmës së Shabanit dhe i fal të gjithë krijesat e Tij, përveç atij që i bën shirk dhe ngatërrestarin!".

Të ndalemi pak dhe të mendojmë. Po të shohim me vëmendje, shumica e grindjeve në shoqëri ndodh për shkaqe banale, për teka e kapriço, për një zemërim të pafrenuar, a një nxitim të papërmbajtur!? Që do të thotë se pajtimi është i mundur dhe krejtësisht i realizueshëm, kur vullnetet e mira vendosen në shinat e udhëzimit hyjnor!

Ky është momenti për t'u paqtuar e për t'ia bërë hallall njëri-tjetrit, për të fituar kënaqësinë e zemrës dhe rehatinë e shpirtit!

Kjo është thirrje, sidomos për ata që janë në hasmëri, që nuk shkojnë e nuk komunikojnë më në mes vete, për ata që kanë probleme brenda familjes, burrë-grua, vëlla-vëlla, motër-motër, etj.; boll më, për hatër të Zotit!

Bini lanet shejtanit dhe kthehuni për hatër të All-llahut të Madhëruar se Ai do e begatojë jetën tuaj me bekimet e Tij të pakufishme!

Fitoni kënaqësinë e Zotit të botëve, i Cili në këtë Natë të Madhe dhuron mëshirë e falje, sidomos për mëshiruesit e falësit në mesin e krijesave të Tij!

Është momenti më i mirë për t'u dëshmuar si robër të Zotit Një, jo robër të nefsit tonë, të tekave e kapriçove verbuese!

Imam Bejhekiu na tregon nga Nana e jonë Aishe (r.a.), në një hadith të gjatë, se Resulull-llahu (a.s.) i tregoi për Natën e Gjysmës së Shabanit, duke i thënë: "O Aishe, a e din ti se cila natë është kjo? Kjo është Nata e Gjysmës së Shabanit, në të cilën All-llahu fal ata që kërkojnë falje, mëshiron ata që kërkojnë mëshirë dhe lë në gjendjen e tyre të zotët e inateve dhe urrejtjes!".

ËSHTË NJË KOHË PËR TË THIRRUR VETEN DREJT PENDIMIT DHE KËRKIMIT FALJE, DREJT NDREQJES SË GABIMEVE DHE HEQJES DORË NGA VESE E DEVIJIME NË SJELLJEN DHE KOMUNIKIMIN TONË, QË NA LARGOJNË NGA DYERT E DASHNISË SË KRIJUESIT MËSHIRËPLOTË!

Prandaj falni dhe mëshironi, dhuroni mirësi dhe pendohuni, se dyert e mëshirës dhe faljes hapen në këtë Natë të Madhe për të përfituar kërkuesit e ndryshimeve të mëdha në jetë!

Shtoni adhurimet e lutjet, dhikret e salavatet, sadekatë e shenjat e mëshirës e dashnisë, sidomos me prindët, në familje, me farefisin e komshitë, me të afërmit e nevojtarët!

All-llahu ju begatoftë dhe ju dashtë!

Shkodër, më 7 prill 2020

MESAZHI I MYFTIUT TË SHKODRËS, ME RASTIN E MUAJIT TË BEGATË TË RAMAZANIT 1441/2020

Të dashur dhe të shtrenjtë vëllezër dhe motra besimtarë,

Bashkëqytetarët e mi,

Bashkëkombas të dashur dhe të shtrenjtë, kudo që ndodheni,

Me zemër të mirë Muajin e Begatë të Ramazanit!

Tashmë, ditën e xhuma, më 24 prill 2020, ne dhe mbarë bota islame bëhemi gati të nisim adhurimin tridhjetë ditor të Muajit të Madhnueshëm të Ramazanit, agjërimin e tij.

I Dërguari i All-llahut, Hz. Muhammedi (a.s.) thotë: "Ju erdhi Ramazani... Ju mëshiron All-llahu në të..."!

Vetëm po të ndalemi në këtë fjali të shkurtër, nga një porosi e gjatë e të Dërguarit të Zotit, ne kuptojmë vlerën e madhe që ka ky Muaj i Begatë i Ramazanit, i cili na afron në çdo moment të tij me mëshirën e Zotit, me faljen e Tij, si dhe më dashurinë e Tij të madhe për ne dhe krejt krijesat e Tij!

Pra, është momenti që t'i dëshmojmë All-llahut, Zotit të gjithësisë, më të mirën nga vetja e jonë, në sjelljen tonë, në përkushtimin tonë, në marrëdhënie me familjen, me farefisin, me komshinjtë, me shoqërinë dhe me çdo krijesë prej krijesave të Zotit!

Muaji i Begatë i Ramazanit është mundësia e privimit nga sjelljet që e dëmtojnë marrëdhënien tonë solide me Zotin.

Është mundësia e privimit, e largimit dhe e distancimit maksimal nga çdo sjellje që na largon nga mirëkuptimi, paqja dhe harmonia në marrëdhënie me të tjerët, kushdo qofshin ata!

Sepse njeriu është vëlla i njeriut!

Sepse ne kemi ardhur në këtë botë, që nëpërmjet vlerave të besimit dhe mësimeve të Librave të Shenjtë të ndërtojmë ura komunikimi, paqeje dhe harmonie në mesin e njerëzve!

Të dashurit e mi,

Ramazani i sivjetshëm na gjen në një gjendje ndryshe nga ato të viteve të kaluara.

Do të dëshironim që edhe sivjet të faleshim në xhamitë tona, si vitin që kaloi e vitet më parë. Do të dëshironim që të falnim namazet ditore me xhematë, namazin e teravisë, atë të xhumasë, të merrnim pjesë në leximin e përditshëm të Kur'anit Famëlartë, të merrnim pjesë në ligjëratat e imamëve tanë të nderuar.

Porse, për arsye që tashmë dihen dhe, në të gjithë botën islame, janë bërë shkak që të privohemi nga kjo mirësi e madhe, sivjet do të përpiqemi që në këto kushte të reja dhe në një realitet të ri ta dëshmojmë forcën e besimit, të shpresës dhe të optimizmit në Zotin e gjithësisë!

Të dëshmojmë forcën e karakterit dhe të besimit në zemrat tona, në harmoni me familjen dhe pjestarët e saj, duke i dëshmuar njëri-tjetrit mirësinë e besimit dhe vullnetin për ta përjetuar çdo moment të këtij Muaji të Begatë me besim dhe durim, me shpresë dhe optimizëm, se Zoti i gjithësisë është Mëshirues, Mëshirëbërës, na do dhe e ka bërë këtë Muaj të Begatë derë të madhe të afrimit me dashurinë e Tij!

Unë lutem me zemër që All-llahu i Madhëruar t'ju begatojë, të derdhë mëshirë dhe mirësi mbi secilin prej jush, ta begatojë vendin tonë, tokën tonë, shoqërinë tonë, mbarë njerëzimin!

Me zemër të mirë Muajin e Ramazanit!

Imam Muhamed B. Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

Shkodër, më 23 prill 2020

MYFTIU I SHKODRËS APELON PËR KUJDES MAKSIMAL DHE JO PANIK

Pas rasteve të shtuara me Covid 19 në qytetin e Shkodrës, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, iu drejtua mbrëmjen e shkuar qytetarëve shkodranë me një mesazh të drejtpërdrejt, që të bëjnë kujdes maksimal dhe të ndjekin udhëzimet e duhura, për të ruajtur veten dhe familjet e tyre nga pandemia që ka përfshirë mbarë botën.

"Kam një shqetësim jo të vogël sot, por edhe gjatë gjithë këtyre ditëve, që nga momenti kur kryeministri i vendit deklaroi se Shkodra është një minë me sahat.

Në fakt unë nuk kam dëshirë që askush ta përmendë Shkodrën duke e etiketuar atë si minë me sahat, sepse Shkodra nuk ka qenë, as mund të jetë e tillë!

Por, kur bëhet fjalë për mirëqenien e njerëzve, për sigurinë dhe shëndetin e tyre, të gjithë duhet të angazhohemi dhe të punojmë maksimalisht për të ruajtur veten tonë, fëmijët tanë, prindërit tanë, të moshuarit tanë, rininë tonë, shoqërinë tonë nga e keqja dhe nga e padëshiruara!

Kam një shqetësim jo të vogël sot, por edhe gjatë gjithë këtyre ditëve, që nga momenti kur kryeministri i vendit deklaroi se Shkodra është një minë me sahat.

Në fakt unë nuk kam dëshirë që askush ta përmendë Shkodrën duke e etiketuar atë si minë me sahat, sepse Shkodra nuk ka qenë, as mund të jetë e tillë!

Rastet në rritje, siç thonë, të njerëzve të prekur nga kjo pandemi në qytetin tonë, na nxisin përherë e më tepër që t'i bëjmë thirrje të afërmve, të dashurve, bashkëqytetarëve tanë që të jenë të kujdesshëm maksimalisht, sepse kushtet në të cilat gjendet vendi ynë janë të atilla që nuk e përballojnë dot një rëndesë kaq të madhe të shtimit të numrit të prekurve nga një virus si ky, që edhe pse nuk është vdekjeprurës dhe është rrethuar me shumë propaganda paniku, gjithsesi mbetet shqetësim për njerëzit!

Kjo është një thirrje nga zemra e një vëllait tuaj dhe e një njeriu që ju do të mirën dhe që nuk ka asnjë interes në këtë mesele, veçse të thojë një fjalë të mirë!

Prandaj, ju lutem me zemër që maksimalisht të ruhemi! Disa dalje e lëvizje që jemi mësuar t'i bëjmë çdo ditë dhe na i ka qejfi t'i bëjmë, mua të parit; por që kemi mundësi t'i reduktojmë dhe të privohemi prej tyre, t'i reduktojmë dhe të privohemi prej tyre sot, që të mos vuajmë nesër!" -, tha ndër të tjera Myftiu.

Ai bëri lutje për mëshirë dhe mirëqenie, sikurse iu drejtua tregtarëve dhe atyre që kanë mundësi të ndajnë zekatin, të mos hezitojnë, sepse ndarja e hakut të Zotit për të varfrit dhe skamnorët, tërheq mëshirën dhe bekimet e Zotit për ne!

Shkodër, më 14 prill 2020

AGJËRIMI ËSHTË MBUROJË..!

Në jetën e njeriut ka momente, ku e mira me krejt dimensionet e saj shfaqet në horizontet e tij, duke e ftuar të përfshihet në atmosferën e tyre bekuese, ku i jepet mundësi të marrë e të përfitojë, për të përmirësuar gjendjen, për t'u lartësuar në miraxhet e lutjes dhe kërkimit të pëlqimit të Zotit të tanësisë, për të kërkuar falje para duarve të Tij, për gjynahet e ndryshme, për të ndrequr gabimet e shumta në përditshmërinë e marrëdhënieve të tij me veten e me të tjerët, për të kërkuar mëshirë e udhëzim për pjesën e mbetur të jetës, për të ndriçuar zemrën me dritat e dhikrit e adhurimeve, për të shtruar nefsin në udhën e përkushtimit e për të vënë atë në shinat e pranimit!

"Çdo gjë e ka një stinë, çdo mall e ka një treg, çdo nevojë e çështje e ka kohën dhe momentin e vet. Prandaj, kur njeriu kërkon për nevojën e tij, e gjen atë në një treg, sikurse, kur vrapon pas interesit a kërkesës së tij, në kohën dhe momentin e duhur, është i mundur ta gjejë e ta mbërrijë atë...

Poashtu edhe falja e gjynaheve dhe shlyerja e gabimeve ka stinën, kohën dhe ditët e veta të caktuara; ai që përkushtohet në realizimin e pendimit të tij, e arrin qëllimin dhe dëshirën e tij...".[1]

Padyshim, një ndër këto momente të spikatura dhe të shumëpritura, është edhe muaji i begatë i Ramazanit, që sa herë vjen, sjell me vete një frymë të mrekullueshme përkushtimi dhe përuljeje ndaj vullnetit të Krijuesit të gjithësisë, duke na bërë të gjithëve më të mirë e më të butë, më të ndjeshëm ndaj besimit dhe thirrjes së fesë, më të afërt më njëri-tjetrin, më të prekshëm në raport me skamnorët e nevojtarët në shoqëri.

Subhanallah, vetvetiu besimtari në këtë muaj, angazhohet për të bërë mirë, për të jetuar mirë, për të dhuruar mirësi e për të mbyllur krejt dyert e të keqes, duke mos i lënë shkas askujt të depërtojë me shigjetat e shejtanit, madhështinë nuranite të këtij muaji mubarek!

Në përkufizimin e agjërimit, thuhet se ai është: "Privimi nga ushqimi, pija, marrëdhëniet intime bashkëshortore dhe çfarë i bashkëngjitet atyre, nga koha agimit të dytë deri në perëndimin e diellit."[2]

Ndërsa Ibn Sejjidihi ka thënë: "Agjërimi është lënia e ushqimit,e pijes, e marrëdhënieve intime bashkëshortore dhe e fjalëve!"[3]. E nënvizova këtë detaj, sepse shpeshherë fjala bëhet rrugë për depërtimin e hiseve të nefsit dhe të shejtanit, duke prishur zemra, duke ngatërruar miqësi e duke shkatërruar ura komunikimi e marrëdhëniesh në mesin e njerëzve!

Prandaj, Resulull-llahu (a.s.) na porosit: "Agjërimi është mburojë, prandaj (agjëruesi) mos të flasë fjalë të ulëta, as mos të shfaqë shenja të sjelljeve të injorancës[4], e nëse dikush e ngacmon, ose e shan, le të thojë: Unë jam agjërueshëm, dy herë!

Pasha Atë që e ka frymën time në dorën e Tij, shija e gojës së agjëruesit është më e mirë tek All-llahu (në ditën e gjykimit) se era e miskut!

(All-llahu i Madhëruar thotë për agjëruesin:) E të ushqimin e tij, pijen e tij dhe epshin e tij për hatrin Tim! Agjërimi është i Imi dhe Unë e jap shpërblimin për të dhe, e mira shumëfishohet për dhjetëfishin e saj!".[5]

Ndërsa në transmetimin e Imam Daremiut: "Agjërimi është mburojë, përderisa nuk e shqyen atë me përfoljen e të tjerëve pas shpine (me gibet)".[6]

Prandaj, të dashur vëllezër dhe motra, të bëhemi gati për të përfituar nga kjo mirësi e madhe që po na vjen, sepse koha ikën dhe i lumi ai që përfiton nga bekimet e All-llahut në hapësirat e saj!

Të bëhemi gati e të pastrojmë zemrat me dhikër e kërkim falje, shtëpitë tona me mbledhjen e fëmijëve dhe familjarëve përreth mihrabit të lutjes e përkushtimit, hapësirat tona me përkushtimin e zemrave dhe përpjekjen e vazhdueshme për të falur mirësi e paqe!

"Muaji i Ramazanit është muaj i pendimit dhe i faljes, muaj i bindjes dhe i mirësisë, muaj i dhikrit dhe i dashnisë, muaj i përkushtimit dhe i afrimit. Resulull-llahu thoshte: 'I ngrati ai njeri, që i vjen Ramazani dhe nuk i falen gjynahet'[7]".[8]

Pra, të gjithë e kemi një mundësi të jashtëzakonshme për të përfituar mëshirën dhe faljen e Zotit tonë në këtë Muaj!

Secili prej nesh e ka mundësinë e madhe të përkushtohet me krejt forcat e tij, për të dëshmuar më të mirën nga vetja e tij, për të parë se sa e mrekullueshme është jeta e disiplinuar me rrugëtimet

e paqta drejt fitimit të pëlqimit të Zotit në jetë!

Sa e bukur është dita që nis me vullnetin për të agjëruar, me zgjimin që në orët e para të para agimit, me përgatitjen për të ngrënë syfyrin në një kohë lutjesh, me faljen e namazit të sabahut me xhematë, me leximin e dhikreve dhe virdeve të përditshme të Kur'anit Famëlartë, me nijetin e hatmes, pas së cilës ka edhe një lutje të pranuar, siç ishte edhe tradita e bukur e sahabëve të shtrenjtë.

Sa e begatë është dita, teksa në vetëdijen tonë ne jemi agjërueshëm, pra, të dorëzuar para vullnetit të Zotit tonë, larg tendencës për të bërë dëm, a për të lejuar të na bëhet dëm; larg thashethemit, a cytjes për të na përfshirë në të; larg inatit, smirës e urrejtjes për krijesat e Zotit!

Sa i bukur është ai moment, kur ulemi në tryezën e iftarit, duke pritur çastin e këndimit të ezanit, për të bërë një duâ, për të dhuruar një buzëqeshje, për të marrë një lutje nga prindërit e dashur, për të falur një bekim për fëmijët tanë, për të dëshmuar bashkërisht një moment sublim, që na lidh me mirësinë tridhjetë ditore të këtij Muaji të Madhëruar!

Ky është Muaji që të gjithë e presim, për t'u angazhuar edhe më shumë me hakun e Zotit dhe hakun e fesë së Tij në jetën tonë; duke u privuar nga disa lejueshmëri në harkun e disa orëve, duke e angazhuar veten me leximin dhe kuptimin e Kur'anit, duke iu përkushtuar haditheve dhe leximit e kuptimit të jetës dhe shembullit të Hz. Muhammedit (a.s.), duke u përpjekur për të dhënë e për të fituar kënaqësinë e All-llahut të Madhëruar në çdo frymë të kësaj periudhe të begatë, duke ruajtur me korrektësi faljen e namazeve në kohën e duhur, si dhe duke afruar familjen rreth sofrës së udhëzimit dhe dritës së besimit e të fesë.

Në leximet e të parëve, gjeta edhe këto shënime të përmbledhura nga trashëgimia e të urtëve, ku ndër të tjera shkruhet: "Këtê muej të famshëm e ka stolisun i Madhi Perendí me fillimin e komunikimit të Kur'anit të shêjtë. Në këtë muej u vu themeli i parë i fés së naltë, e cila âsht kulmi i të parave, i féve Hyjnore... Erdhi pra koha të plotsohet feja Islame, qi pat fillue qysh me Hazreti Ademin.

...

Njeriu duhet t'a mendojëdy minuta dhe t'a pyesë vehten mbi shkakun, pse âsht krijue, ç'âsht misjoni i tij, pse vdes dhe ç'âsht jeta e errët e tij mbas vdekje. Nuk ka ardhë në këtê botë vetëm me ngranë, me pí e me dëfrye, sikur shtâzët. Te njeriu mshihet nji qellim tjetër, qellim shumë i naltë, i cili e dalloi njerinë nga shtâzët e tjera...

Mbasi çështja qëndron kështu, nuk duhet me dhanë gjykim të shpejtë mbi Ramazanin e bekuem, si e kanë zakon disa materjalistë, të cilët kujtojnë se fitojnë lavdí tue e mohue e përbuzë Ramazanin. Kush përbuzë Ramazanin bân tre faje: 1) Bân faj para vehtes, pse e tregon se s'ka ndjenje shpirtnoree morale. 2) Bân faj para ligjit, pse përbuzë atê qi tjetri e ka shumë të shêjtë. 3) Bân faj para Zotit, sepse përbuz urdhnin e Tij.

...

Agjinimi âsht adhurimi mâ i pëlqyeshëm, sepse âsht sekret, bâhet fshehtas e kryhet drejt për drejt për hirin e të Madhit Zot.

Agjinimi ka edhe cilësi higjienike e morale: e çvesh njerín nga të gjitha cilsít shtâzore dhe e afron me cilsít hyjnore, e ban të durueshëm dhe i ep idé mbi urín e varfrís dhe e ban zemër mirë para tyne...".[9]

All-llahut të Madhëruar i lutemi tëna mundësojë t'ia mbërrijmë këtij bekimi të madh dhe të përfitojmë nga çdo ditë e natë e kësaj periudhe 30 ditore për t'u paqtuar me Zotin, për t'u kthyer në gjirin e besimit, për të hapur një faqe të re me Krijuesin dhe krijesat! Amin!

Derdhe o Dritë atë begati,
Qi t'a fali Zoti për mirësi,
Neve të bindun na ke gadi,
Qi të vish ç'do Vit me mbarësi...[10]

Imam Muhamed B. Sytari
Myfti i Zonës Shkodër
Shkodër, më 17 prill 2020

---

[1] Shejkh Ahmed Keftaro, Min hedjil-Kur'an, Damask, pa vit botimi, tema me titull: "Përfitimi nga stinët e mëshirës", f. 241.

[2]Imam Bedruddin El-Ajni (v. 855 h.), në Umde-në e tij, (shpjegimi i Sahihul-Bukhariut), botimi i dytë, Liban, 2009, vëll. i 10-të, f. 361.

[3] Po aty, f. 361.

[4] "Si britmat, veprat e ulëta dhe tallja" – Imam Bedruddin El-Ajni (v. 855 h.), vep. e cit., vëll. i 10-të, f. 367.

[5] Transmetuar nga Imam Bukhariu, nga Ebu Hurejra (r.a.).

[6] Të shihet: Imam Bedruddin El-Ajni (v. 855 h.), vep. e cit., vëll. i 10-të, f. 367.

[7]Transmetuar nga Imam Bukhariu në 'Edebul-mufred', nga Ebu Hurejra (r.a.), hasenun-sahih. Poashtu Tirmidhiu nga Ebu Hurejra (r.a.) me përafërsi.

[8]Dr. Muhammed Ratib En-Nabulsi, Teemulat fil-Islam, botimi i parë, 2013, Amman, f. 109.

[9]H.Sh. (Haki Sharofi), Ç'ka asht Ramazani?, në revistën Zâni i Naltë, vjeti VI, Ramazan 1348 – Fruer 1930, nr. 3, Shkodër, 1930, f. 934-936.

[10]F.V. (Ferit Vokopola), Hana e Ramazanit, në revistën Zâni i Naltë, vit' i IV, Kallnur 1927, nr. 6, Shkodër, 1927, f. 173.

ADHURIMET NË RAMAZAN

Lavdrim Hamja
Imam - xhamia e "Dy Vajzave"

Ibn kajjimi, Allahu e mëshiroftë në lidhje me dispozitat e Islamit ka një shprehje apo një thënie shumë të bukur, i cili thotë: "Në Sheriatin islam nuk ka asnjë dispozitë të vetme që të mos ketë kuptim dhe urtësi. E kupton, kush e kupton dhe nuk e kupton ai që nuk e kupton. Prej këtyre kuptimeve dhe urtësive për shembull është abdesi. Përse ne kur marrim abdes, lajmë disa pjesë të veçanta të trupit? Ose, falja e namazit me lëvizjet e tij, kur falim namazin, lëvizim duart, qëndrojmë në këmbë, bëjmë rukunë (përkuljen), bëmë sexhden (përuljen), pra gjithë këto lëvizje të veçanta kanë kuptim dhe urtësi. Po ashtu edhe agjërimi ditën dhe jo natën apo kryerja e Haxhit me ato ritet e veçanta dhe të spikatura të tij.

Kështu, në Sheriatin Islam çdo adhurim e çdo detyrë e caktuar nga Zoti i Madhëruar ka kuptimin e saj dhe urtësinë, të cilën me të vërtetë jo të gjithë njerëzit ia dinë ose e kanë zbuluar.

Allahu i Madhëruar i ka obliguar këto adhurime dhe obligime për të lartësuar njeriu dhe për të edukuar sjelljen e tij. Me të vërtetë nuk ka periudhë as kohë më të mirë e më të duhur dhe më të begatë që njeriu të praktikojë moralin e tij e të edukojë sjelljet e tij, qofshin këto fizike ose morale, sepse në këtë periudhë mëshira, begatia dhe mirësia e Zotit është e pakufishme.

Nëse kujtojmë hadithin e Pejgamberit (a.s), i cili thotë se, "Kur vjen Ramazani hapen dyert e xhenetit dhe shejtanët lidhen ose prangosen", do të thotë që njeriu në këtë muaj e ka shumë të lehtë, jo vetëm që t'i kryejë këto obligime, por edhe veset e tij, që mund t'i ketë krijuar gjatë gjithë vitit, i ka shumë të lehta t'i edukojë dhe t'i sjellë, sepse siç e dimë gjithmonë në këtë botë, e mira dhe e keqja është në luftë, është në kontradiktë, se cila do të fitojë ndaj njëra-tjetrës.

Nëse ne në veten tonë kemi gjithmonë një grindje mes të mirës, asaj që na nxit për të bërë mirë dhe epshi, i cili nuk është ai që duhet të veprojë njeriu, por janë ato kërkesat e duhura që duhet të zbatojnë, brenda këtij muajit të Ramazanit, kur njeriu pakëson ushqimin, pra pakëson energjitë e tij, këto epshe bien dhe në këtë mënyrë triumfon ajo që është më e saktë, ajo që është më e duhura, ajo që i shërben njeriut në këtë botë dhe në botën tjetër.

Muaji i Ramazanit është muaji me të vërtetë, i cili e ndihmon njeriun. Nëse agjëron saktë, duhet të rregulloje moralin e tij, të disiplinojë sjelljet e tij, veset e tij dhe të bëhet shumë më tepër sesa një njeri i zakonshëm, të bëhet human, të bëhet një njeri, i cili me të vërtetë i shërben vetes së tij, i shërben komunitetit, i shërben familjes, i shërben popullit, i shërben mbarë botës dhe kështu bëhet njeriu më i dashur te Zoti (xh.sh), siç ka thënë Pejgamberi (a.s): "Njeriu më i dashur tek Allahu, është ai që është më i dobishëm për njerëzit".

Ndërsa, nëse ne i kryejmë ato obligime thjesht si rutinë, pra qëndrojmë agjërueshëm, ose më mirë të themi, qëndrojmë pa ngrënë dhe pa pirë, e nuk disiplinojmë sjelljet dhe moralin tonë, ose falemi thjesht për të kryer disa lëvizje e adhurime të tjera, këto nuk kanë dobi. Siç e përmendëm në fillim, pra çdo dispozitë në Islam ka kuptimin dhe urtësinë e saj dhe ne duhet t'ia zbulojmë ato urtësi. Në lidhje me këtë, Shejkh Muhamed El-Gazali, Allahu e mëshiroftë, ka thënë kështu: "Cila është vlera e namazit dhe e agjërimit, nëse këto të dyja nuk ia mësojnë njeriut pastërtinë e shpirtit dhe të gjymtyrëve"?

Pra, cila është ajo dobi nëse ne falemi dhe agjërojmë, e nuk na e pastrojnë shpirtin as nuk na pastrojnë gjymtyrët, nuk na e pastrojnë gjuhen nga të folurit keq ose duart nga të bërit keq, që do të thotë me të vërtetë qëllimi i obligimit në Islam është të edukojë njeriun.

Le t'i trajtojmë më ngadalë, se përse Allahu (xh.sh) i ka caktuar këto obligime? Cila është ndjesia e tyre? Cila është vlera apo urtësia e tyre që Zoti i ka vendosur?

Po fillojmë me Kur'anin Famëlartë. Allahu i Madhëruar thotë në Kuranin Famëlartë: "Nuk ka dyshim, se me të vërtetë ky Kur'an udhëzon drejt asaj që është më e drejtë, më e saktë, më e mirë dhe i përgëzon besimtarët", pra cilët besimtar? "Ata të cilët kanë besuar dhe punojnë vepra të mira se do të kenë shpërblim të madh". Në një ajet tjetër përsëri për Kur'anin Famëlartë, Allahu i Madhëruar thotë: "O ju njerëz" - pra këtu Allahu i Madhëruar i drejtohet mbarë njerëzimit, jo vetëm atyre që kanë besuar, që të kuptojnë se ky Kur'an nuk është libër dosido, ka vlera dhe ka peshë të madhe, është fjala e Allahut për mbarë njerëzimin që t'i udhëzojë në rrugën e drejtë - "O ju njerëz, ju ka ardhur këshillë prej Zotit tuaj dhe shërim për atë që është në gjoks" - pra shërim për atë që është në zemrën e çdo njeriu, prej mllefit ndoshta prej urrejtjes, prej inatit, pra ky Kur'an, leximi i tij dhe praktikimi i tij i shëron zemrat - "Dhe udhëzim dhe mëshirë për besimtarët", e kështu sigurisht që ajetet në lidhje me të mirën ose mirësinë që Allahu (xh.sh) ka vendosur në Kur'anin Famëlartë, në fjalën e Tij janë të panumërta.

"CILA ËSHTË VLERA E NAMAZIT DHE E AGJËRIMIT, NËSE KËTO TË DYJA NUK IA MËSOJNË NJERIUT PASTËRTINË E SHPIRTIT DHE TË GJYMTYRËVE"?

Duhet që njeriu brenda këtij muaji të Madhërishëm, i cili është muaji i zbritjes së Kur'anit, ashtu si çdo njëri prej nesh që përkujton ato përvjetorët e tij, çfarë do qofshin ato, besimtari madje edhe njeriu në përgjithësi, duhet të përkujtojë zbritjen e Kur'anit në muajin e Ramazanit; ka zbritur, pra ka filluar zbritjen në muajin e Ramazanit. E kur njeriu e lexon dhe e përfundon leximin e tij në muajin e Ramazanit, sigurisht që ka më shumë dobi edhe më shumë vlerë, sepse edhe atmosfera e muajit të Ramazanit është e mbuluar me mëshirën e Zotit.

Le t'i marrim me radhë adhurimet, përse Allahu (xh.sh) e ka obliguar namazin?

NAMAZI

Në Kur'anin Famëlartë i drejtohet Pejgamberit (s.a.s) duke thënë: "Lexo atë që të është shpallur prej librit dhe fale namazin. Me të vërtetë, namazi të largon nga veprat e këqija dhe nga haramet" - pra gjërat e ndaluara që të dëmtojnë - "Por përmendja e Allahu është më e madhe. Allahu e di atë që veproni" - pra qëllimi i namazit është që kur njeriu e fal këtë namaz, kur e kryen këtë obligim, këtë detyre shumë të rëndësishme të pastrojë shpirtin, të pastrojë gjymtyrët e tij pra të largohet nga veprat që janë të ndaluara që dëmtojnë veten, dëmtojnë dhe të tjerët dhe të largohet nga ato harame, nga ato ndalesa që Zoti i ka ndaluar vetëm për të mirën e njeriut, sepse i bëjnë dëm atij.

Pejgamberi (s.a.s), në një hadith të cilën e transmeton Ibn Mesudi dhe ibn Abassi (r.a), thotë: "Atë njeri që nuk e ndalon namazi i tij prej veprave të këqija dhe prej harameve" - pra prej ndalesave - "Nuk i shton tek Allahu ky namaz, veç se largësi" - pra një njeri që fal namazin, por nuk e ka moralin në rregull, nuk e ka sjelljen në rregull, domethënë ky namaz nuk e pengon prej gjërave të këqija, prej gjërave të ndaluara, prej dëmeve vetes apo të tjerëve; në qoftë se ky namaz nuk e lartëson njeriun në sjelljen e tij, në moralin e tij, atëherë tek Allahu nuk është afruar por është larguar me këtë namaz.

AGJËRIMI

Allahu i Madhëruar, që në ajetin e agjërimit" thotë: "O ju që keni besuar, agjërimi ju është bërë obligim, siç ka qenë obligim edhe për ata që kanë qenë para jush, në mënyrë që të bëheni më të devotshëm" - pra më të përkushtuar. Këtu është ajo urtësia, pra këtu Allahu (xh.sh) na ka zbuluar urtësinë dhe kuptimin e agjërimit që të bëhemi më të përkushtuar; dhe njeriu quhet i përkushtuar, ose çfarë do të thotë që të jesh i përkushtuar? Është ai i cili zbaton ato urdhra, pra bën mirë ashtu siç ka urdhëruar Allahu (xh.sh) dhe ndalohet prej të këqijave që Zoti i ka ndaluar ato, ky quhet përkushtim.

Pejgamberi (a.s) ka thënë: "Kush nuk lë fjalët dhe veprat e tij të këqija" - pra nëse një person është agjërueshëm dhe nuk i lë fjalët dhe veprat e këqija - "Allahu nuk ka nevojë për atë njeri, të lërë ushqimin dhe pijen e tij" - Nuk është qëllimi që njeriu të dënojë apo ndëshkojë veten e tij me ushqim dhe me pije. Qëllimi i agjërimit është që njeriu të lartësohet, që njeriu të edukojë sjelljen e tij, të kalisë durimin e tij, pra të edukojë ato vepra të cilat janë akumuluar gjatë 11 muajve të tjerë.

ZEKATI

Për zekatin, Allahu i Madhëruar i drejtohet Pejgamberit (s.a.s) duke thënë: "Merr prej pasurisë së tyre sadaka" - domethënë zekatin - "Për t'i pastruar shpirtin dhe për t'ua shtuar të mirat" - pra qëllimi është që të pastrojnë. Shikoni, se si janë të lidhura gjitha adhurimet në Islam që të edukojnë shpirtin, anën morale, por dhe anën fizike, sepse çdo adhurim në Islam ka dy të mira, edhe anën moralen, atë të edukimit të shpirtit, por edhe anën e edukimit apo pastrimit të gjymtyrëve, sepse në Islam nuk ka dallim mes dynjasë dhe ahiretit, nuk ka dallim mes shpirtit dhe trupit, të gjitha janë dhuratë nga Allahu i Madhëruar dhe ne jemi përgjegjës për to dhe ne duhet të mbajmë dhe të ruajmë këtë ekuilibër dhe balancë, që Zoti e ka vendosur në secilin prej tyre, pra te dyja me edukimin e shpirtit dhe edukimin e trupit, domethënë të gjymtyrëve.

RAMAZANI ËSHTË MUAJI I KUR'ANIT DHE NUK MUND TË IMAGJINOHET NJË NJERI, I CILI GJITHË DITËN AGJËRON DHE TË MOS LEXOJË KUR'ANIN, FJALËN E ZOTIT

HAXHI

Allahu i Madhëruar thotë pikërisht për Haxhin: "Haxhi është në muaj të caktuar, kush e ka bërë obligim të kryej Haxhin në to, atëherë të mos veprojë e të mos bëj keq e të mos debatojë dhe çfarë do të mire që të bëni atë e di Allahu dhe përgatituni sepse përgatitja më e mirë është përkushtimi. Më përkujtoni Mua, o të zotët e mendjes".

Pejgamberi (s.a.s) në lidhje me Haxhin në një hadith thotë: "Kush bën Haxh për hir të Allahut, e nuk vepron e nuk bën keq, atëherë ai kthehet si ditën që e ka lindur nëna e tij". - Domethënë, kthehet i pastruar prej gjynaheve, kthehet i pastër dhe fillon një jetë të re apo një cikël të ri në jetën e tij, të cilin duhet të kujdeset, ta mbajë pastër e të mos njollosin me fjalët apo veprat e tij të këqija.

Kështu, të gjitha adhurimet në Islam e kanë kuptimin edhe urtësinë tyre, të edukojnë moralin e njeriut, të edukojnë sjelljet e tija,të kalisin gjithë ato vese, durimin, etj.

Nuk ka dyshim se muaji i Ramazanit është muaji më i mirë për praktikimin e këtyre obligimeve. Me të vërtetë nëse dikush do që të bëhet korrekt me kryerjen e këtyre adhurimeve, le ta fillojë me muajin e Ramazanit, sepse mëshira e Allahu është kudo, është shumë e madhe, është e pranishme përherë. Mëshira e Allahut, me kuptimin që Zoti e ndihmon robin e tij që ti kryejë sa më lehtë këto obligime, që pastaj me kalimin muajit të Ramazanit, atij person i bëhet krejt normale falja e namazit, agjërimi i nafileve të ndryshme që ka, dhënia e zekatit, sepse zekati nuk është vetëm në muajin e Ramazanit apo kryerja e Haxhit, i cili me të vërtetë është obligim një herë në jetën e njeriut, por njeriu duhet ta kryejë kur e ka mundësinë, e jo ta vonojë atë.

Njeriu nuk bën pa ligje e pa rregulla, ashtu si në jetën tonë të përditshme, vendoset kushtetuta, vendosen ligje për t'i disiplinuar njerëzit për të vendosur rregulla, Allahu i Madhërishëm i ka vendosur këto rregulla e dispozita vetëm për të mirën e njeriut, që jeta të shkojë në mënyrë normale, në paqe dhe të sigurt.

Në përfundim, një këshillë për veten dhe për gjithë ju, meqenëse jemi në muajin e Ramazanit, le ta kalojmë sa më mirë duke rregulluar orarin dhe kohën tonë, që të përfitojmë sa më tepër. Le ta kalojmë këtë muaj Ramazani me adhurime, me lutje duke iu lutur Allahut (xh.sh), sepse lutja në këtë muaj, sidomos para iftarit, ka thënë Pejgamberi (a.s) është e pranuar; ta përmendim Allahun sa më tepër; Allahu i Madhëruar thotë: "Më përmendni Mua, Unë do t'ju përmend juve", domethënë kur përmendim Zotin, Allahu na përmend me të mirat e Tij, me begatitë e Tij, me mbrojtjen e Tij.

Ta lexojmë Kur'anin, sepse Ramazani është muaji i Kur'anit dhe nuk mund të imagjinohet një njeri, i cili gjithë ditën ka agjëruar dhe mos ta hapë Kur'anin e mos ta lexojë fjalën e Zotit, që ka zbritur në këtë muaj. Të japin zekatin ata persona të cilët e kanë mirësinë, e kanë begatinë, që ia ka dhënë Allahu i Madhëruar. Filloni e shpërndani brenda muajit të Ramazanit, sepse sevapi dhe shpërblimi i tij është shumë herë më i madh.

Të jemi të kujdesshëm që namazin ta kryejmë në mënyrë të rregullt, të japim sadaka e lëmoshë. Me të vërtetë ndoshta nuk kemi mundësi të shtrojmë iftare por kemi mundësi të ndihmojmë familje të varfra, t'ia dërgojmë këtë iftar, pra këto ndihma tua dërgojmë në shtëpitë e tyre dhe të mos harrojmë Natën e Kadrit, e cila është më e mirë se një mijë muaj, është brenda muajit të Ramazanit, ku mëshira e Allahut arrin kulmin, ku falja e Tij arrin kulmin, prandaj këtë Natë Kadri, ta kalojmë me adhurime e të kujdesemi që të përfitojmë ato mirësi e ato begati të saj.

Dhe, po e mbylli me hadithin e Pejgamberit (a.s): Një njeri erdhi te Pejgamberi (a.s) dhe i tha: Më trego për një punë, të cilin në qoftë se e veproj do të hyjë në xhenet. Pejgamberë (a.s) i tha: "Adhuroje Allahu dhe mos i shoqëro Atij asgjë. Fale namazin farz, jepi zekatin farz dhe agjëro muajin e Ramazanit". Beduini tha: Pasha Atë që shpirti im është në dorën e Tij nuk kam për t'i shtuar gjë këtyre që më the. Kur beduini u largua, Pejgamberi (a.s) tha: "Kush dëshiron të kënaqet duke parë një njeri prej xhenetit, le të shikojë atë person." (Buhariu dhe Muslim)

Shkodër, më 26 prill 2020

AGJËRIMI DHE IMUNITETI I TRUPIT

Durim Kasemi,
Imam - xhamia Parrucë

Nuk ka dyshim se pas çdo urdhri hyjnor për të bërë diçka apo për t'u larguar nga diçka, qëndrojnë urtësi të shumta në dobi të njeriut në këtë botë dhe në jetën tjetër. Edhe agjërimi nuk bën përjashtim nga kjo.

Dobitë e agjërimit janë të shumta dhe shumë dimensionale. Në këtë shkrim do trajtojmë vetëm ato shëndetësore, ose më saktë rreth rolit të agjërimit në forcimin e imunitetit dhe mbrojtjen nga sëmundjet.

Ne si muslimanë besojmë me plot bindje dhe pa asnjë dyshim se agjërimi është i mirë e i dobishëm për ne, në dynja dhe ahiret siç thotë dhe Allahu në Kur'an: "Nëse agjëroni, është më e mirë për ju".

Por, edhe sikur të mos dinim asnjë "urtësi", ne përsëri do thonim: "Dëgjuam dhe u bindëm".

Trajtimi i kësaj çështjeje në këtë mënyrë, vetëm se na e shton bindjen e na e forcon atë, sikur edhe Ibrahimi (a.s), i kërkoi Allahut që t'i tregonte si e ngjallë të vdekurin, jo se kishte dyshim por: "që të qetësohet zemra më tej, e të më shtohet bidnja".

Dua të theksoj se kjo nuk është fusha ime dhe i takon specialistëve të flasin për këtë temë por, duke qenë se shkrimet dhe spekulimet rreth ndikimit negativ të agjërimit tek imuniteti dhe shëndeti i njeriut kanë filluar të nxjerrin kokë edhe në vendin tonë[1], sikur edhe në vende të tjera arabo-muslimane, vendosa të përcjell tek lexuesit shqiptarë atë që specialistët e kësaj fushe e kanë pohuar, duke u mbështetur tek kërkimet dhe eksperimentet shkencore më të fundit, në lidhje me këtë temë.

Një vështrim në studimet serioze - të publikuara nga organe dhe institucione shkencore serioze dhe me reputacion të lartë - që kanë lidhje me imunitetin dhe rolin e agjërimit me llojet e tij të ndryshme tek imuniteti, do vërejmë se agjërimi ndikon në disa aspekte në shëndetin e njeriut.

Në një studim të bërë në vitin 2009 e të publikuar në vitin 2012, është testuar ndikimi i agjërimit me shkëputje e ndërprerje në muajin e Ramazanit tek 50 persona të rritur, meshkuj dhe femra pa probleme shëndetësore. Nga rezultatet është vërejtur mungesa e efekteve negative të agjërimit tek çdo variabël imunitarë tek të testuarit.[1]

Studimi i mësipërm është përforcuar edhe nga një studim tjetër,që është bërë tek 120 vullnetarë të shëndetshëm duke përdorur disa tregues fiziologjik dhe funksional të sistemit imunitarë. Ky studim arriti në përfundimin se: agjërimi në muajin e Ramazanit nuk ka asnjë ndikim negativ në efikasitetin e sistemit imunitar si dhe në funksionet e tij tek të rriturit e shëndetshëm.[2]

Në një studim të ngjashëm tek 21 të rritur, është gjetur se agjërimi i muajit të Ramazanit nuk ka aspak ndikim negativ tek rruazat e bardha të gjakut të llojit Neutrophils, të cilat janë përgjegjëse për mbrojtjen e trupit nga sëmundjet dhe veçanërisht nga ato bakteriale.[3]

Si rezultat i numrit të madh të studimeve lidhur me ndikim e agjërimit të Ramazanit tek sistemi imunitar, janë analizuar 45 studime shkencore të verifikuara e të çertifkuara. Rezultatet e këtij analizimi (të studimeve të publikuara) tregojnë se agjërimi i Ramazanit nuk ka asnjë ndikim negativ tek treguesit imunitarë tek të rriturit e shëndetshëm dhe se nuk rrit rrezikun e prekjes nga sëmundjet infektive si dhe nuk shkakton çrregullime në imunitet.

Gjithashtu, studimet kanë nxjerr në pah se ndryshimet në imunitet që shoqërojnë agjërimin gjatë muajit të Ramazanit janë të vogla dhe të përkohshme, të cilat zhduken me mbarimin e agjërimit.

Studimet gjithashtu kanë gjetur se agjërimi nuk ka asnjë efekt negativ tek treguesit imunitarë tek të sëmurët me astma bronkiale. Kështu që nëse tek të sëmurët me këtë sëmundje, agjërimi nuk përbën problem, atëherë më parësore, nuk bën as tek të shëndetshmit.[4]

Në një përmbledhje studimesh të tjera, rreth llojeve të agjërimit (përveç agjërimit të Ramazanit), rezultatet kanë treguar se agjërimi i ndërprerë dhe llojet e tjera të agjërimit kanë aftësi për përmirësimin e reagimit imunitar si dhe mbrojtjen nga rreziku i të prekurit nga sëmundjet autoimune, si dhe mbrojtjen nga plakja dhe plakja imunitare (Immunosenescene).Gjithashtu studimet kanë treguar për aftësinë që ka agjërimi në eliminimin e qelizave të plakura e të vdekura dhe tretjen e tyre si dhe krijimin e qelizave të reja aktive.[5]

Ndër studimet më të rëndësishme që flasin rreth lidhjes së agjërimit me imunitetin e njeriut, janë ato që flasin rreth ndikimit që ka agjërimi në muajin e Ramazanit tek mekanizmat e antioksidimit dhe mbrojtjes nga infeksionet.

Grupi jonë kërkimor ka mbledhur të dhënat e 12 studimeve shkencore dhe i ka analizuar (këto studime kanë përfshirë 311 agjërues të moshave të rritura). Këto studime kanë trajtuar ndikimin e agjërimit tek faktorët e oksidimit.[2]

Rezultatet e analizimit të studimeve kanë treguar një rënie të dukshme të një sërë numri treguesish të oksidimit dhe infeksionit në fund të muajit të Ramazanit. Kjo e forcon rolin e agjërimit në aktivizimin e imunitetit dhe shtimit të efikasitetit të tij në përballimin e epidemisë dhe sëmundjeve dhe hedh poshtë pretendimet se agjërimi mund të ndikojë pozitivisht në shtimin e epidemisë.[6]

Në një studim tjetër rreth ndikimit të agjërimit tek Ekspresioni i (aktivizimi) gjeneve[3] në lidhje me parandalimin e oksidimit dhe infeksionit tek rreth 60 persona të rritur, rezultatet kanë treguar aftësinë dhe ndikimin e agjërimit për shtimin e ekpresionit gjenetik për disa gjene si: SOD2, TFAM, Nrf2, dhe ky ndikim ka qenë në nivele shumë të larta përkatësisht: 90.5%, 54.1%, 411.5%, në krahasim me nivelet e tyre para agjërimit të muajit të Ramazanit.

Këto rezultate janë shumë të rëndësishme për vërtetimin e aftësisë së agjërimit të muajit të Ramazanit në mbrojtjen nga stresi oksidues dhe infeksioneve përgjegjëse për dobësimin e sistemit imunitar dhe zbehjes së efiçensës së tij në përballimin e sëmundjes.[7]

Në një studim të bërë tek tridhjetë mostra gjaku vullnetarësh, të marra prej agjëruesve dhe i fokusuar tek ndikimi i agjërimit të Ramazanit tek aftësia e trupit për të përballuar infeksionet bakteriale shkaktare të tuberkulozit, të cilin e shkakton bakteri i quajtur Mycobacterium tuberculosis, është gjetur se agjërimi ka aftësi për zvogëlimin e mundësisë së prekjes nga kjo bakterie si dhe rritjen e rezistencës së trupit ndaj saj dhe kjo nëpërmjet rritjes së numrit të qelizave Macrophages.

Gjithashtu studimi ka treguar aftësinë e agjërimit në rritjen e sekretimit të përbërësit Interferon (INF)-Gamma, i cili është i aftë të nxisë mekanizmat e imunitetit që përballojnë infeksionet me të dy llojet e saj bakteriale dhe virusale.[8]

Studimet nuk janë kufizuar vetëm tek personat e shëndetshëm por janë bërë edhe me persona të sëmurë. Në një studim rreth ndikimit të agjërimit të ramazanit tek të sëmurët me HIV-aids, rezultatet kanë treguar se agjërimi nuk ka asnjë ndikim negativ në imunitetin e tyre.[9]

Pra nëse persona të tillë që kanë një problem të madh në sistemin e tyre imunitar, nuk janë në rrezik nga agjërimi, atëherë personat e shëndetshëm dhe pa probleme sigurisht që nuk ka se si të kenë probleme nga agjërimi!

Vlen të përmendet se agjërimi gjatë muajit të ramazanit shoqërohet edhe nga disa zakone,tradita,dhe sjellje shoqërore dhe të ushqyerit. Muaji i Ramazanit nuk është vetëm muaj agjërimi. Ai është muaj ritesh fetare kolektive me plot kuptimin e fjalës. Këtë e tregon më se mirë tubimi i njerëzve në namaz dhe në tryezat e përbashkëta të iftarit.

Ndoshta kjo është sfida më e madhe për komunitetin gjatë Ramazanit. Nuk është ndikimi negativ që ka agjërimi në sistemin imunitar - të cilin e hodhëm poshtë më sipër - ai që përbën një sfidë dhe rrezik por, rreziku i vërtetë konsiston në sjelljet shoqërore të cilat mund të jenë burim i rishfaqjes së infeksionit, siç edhe pretendohet se do ketë rizgjim në një fazë të dytë.

NE BESOJMË ME PLOT BINDJE DHE PA ASNJË DYSHIM SE AGJËRIMI ËSHTË I MIRË E I DOBISHËM PËR NE, NË DYNJA DHE AHIRET SIÇ THOTË DHE ALLAHU NË KUR'AN: "NËSE AGJËRONI, ËSHTË MË E MIRË PËR JU".

Gjithashtu edhe natyra e ushqimeve në muajin e Ramazanit ku mbizotërojnë sheqernat dhe yndyrat, të cilat dobësojnë imunitetin dhe ulin efikasitetin e sistemit imunitar në përballje me virusin dhe dobësimin e efektit të tij. Nisur nga kjo, është e domosdoshme përzgjedhja e ushqimit të balancuar, të pasur me perime, fruta, ligume, fruta të thata të pasura me vitamina dhe minerale të cilat forcojnë sistemin imunitarë.

Gjithashtu vlen të përmendet edhe fakti se agjëruesit duhet të largohen nga vendet e infeksionit dhe ti përmbahen distancimit social për tu mbrojtur nga virusi. Këtu duhet të bëjmë dallimin mes ndikimit të agjërimit si veprim më vete dhe zakoneve e sjelljeve shoqërore që shoqërojnë muajin e ramazanit.

Kjo ishte një paraqitje e shkurtër e studimeve më të njohura rreth ndikimit të agjërimit me llojet e tij të ndryshme, ku bën pjesë edhe agjërimi i Ramazanit tek shëndeti i sistemit imunitar dhe reagimit imunitar dhe eficençës së tij. Siç edhe u pa më sipër, studimet kanë treguar aftësinë e agjërimit për të përmirësuar aftësinë e organizmit në përballjen me infeksionet nga mikrobet dhe virale, gjë kjo që hedh poshtë hipotezën se agjërimi i dobëson imunitetin si dhe ka ndikim negativ të mundshëm në përkeqësimin e ndikimit të Covid-19 në sistemin imunitar.

Krahas kësaj, duhet të kihet parasysh, shkencërisht, asnjë studim prej të sipërpërmendurve, nuk ka verifikuar ndikimin e agjërimit në muajin e Ramazanit tek virusi sars-cov2, që shkakton sëmundjen Covid-19.

Gjithashtu vlen të përmendet edhe fakti se studimet e sipërpërmendura - të kryera tek njerëzit por edhe studime të tjera (që nuk i kam sjellë në shqip - sh.p) të kryera tek kafshët, nuk mund të përgjithësohen edhe tek të sëmurët me Covid-19.

Këtu mbetet në fuqi parimi që i heq të sëmurit detyrimin e agjërimit, ku Allahu thotë: "Dhe kush prej jush është i sëmurë apo në udhëtim - të mos agjërojë - e t'i zëvendësojë në një kohë tjetër". - (Kur'ani, El-Bekare: 184)

Në përfundim, them se ajo çka u përmend më sipër, është vetëm një pjesë e vogël e dobive të agjërimit dhe mirësive të tij, të cilat janë paraqitur në kontekstin e ndikimeve pozitive që ka agjërimi i Ramazanit në aspekte të ndryshme të shëndetit. Këto rezultate janë vërtetuar e janë publikuar në revistat periodike ndër më eminentet në botë siç janë(10), British Journal of Nutrition/ Cambridge(11) European Journal of Nutrition/Springer-Nature, IDF/Diabetes Research and Clinical Practice(12).

Kur dëgjojmë këto fjalë nga studiues të fushës, e kuptojmë më së miri urtësinë fizike dhe trupore të agjërimit përtej asaj shpirtërore dhe imanore dhe na vjen ndërmend thënia e Profetit të Zotit, i cili nuk fliste nga mendja, por me shpallje nga Krijuesi i gjithësisë,në të cilën thotë: "Ena më e keqe që mbushë njeriu është barku i tij. Njeriut i mjafton që të ha disa kafshata që ti mbajë trupin gjallë,e nëse nuk mundet të jetojë kështu, atëherë le të mbushë 1/3 me ushqim , 1/3 me pije, dhe 1/3 ta lërë për frymëmarrje". - (Tirmidhiu)

**Ky shkrim është bazuar tek artikulli me titull: Korona dhe agjërimi i ramazanit, të Prof. Mo'ez Al-Islam E. Faris (Profesor i Asociuar, nutrionist dhe dietolog në universitetin e Sherika, UAE),*

Shkodër, 16 prill 2020

Referencat:

1. https://www.sciencedirect.com/science/article/pii/S0271531712001820
2. https://www.ncbi.nlm.nih.gov/pubmed/18183711
3.https://www.ncbi.nlm.nih.gov/pubmed/19610537
4. https://www.frontiersin.org/articles/10.3389/fimmu.2017.01144/full
5.https://www.sciencedirect.com/science/article/pii/S0303720717300552
6. https://www.sciencedirect.com/science/article/pii/S2352385918300744
7. https://www.sciencedirect.com/science/article/pii/S0168822719302177
8.https://www.semanticscholar.org/paper/Effect-of-Ramadan-Fasting-on-the-Ability-of-Serum%2C-Lahdimaëan-Handono/2c915a812175e2f362c53d5d033d84fec3acb6a
9. https://link.springer.com/article/10.1007/s11357-016-9876-3
10. https://journals.sagepub.com/doi/abs/10.1258/td.2011.110130
11.https://www.cambridge.org/core/journals/british-journal-of-nutrition/article/impact-of-ramadan-diurnal-intermittent-fasting-on-metabolic-syndrome-components-in-healthy-nonathletic-muslim-people-aged-over-15-years-a-systematic-revieë-and-metaanalysis/390F52CFFD34278113368A64787DC14A
12. https://link.springer.com/article/10.1007/s00394-020-02216-1
13.https://ëëë.sciencedirect.com/science/article/pii/S0168822719302050

1. https://www.dw.com/sq/2020-ramazan-pa-iftar/a-53142696

2. Antioksidantët janë përbërës që i prodhon trupi jonë, siç gjenden edhe ne ushqime. Këto ndihmojnë në mbrojtjen e qelizave nga dëmtimi i shkaktuar nga molekulat e quajtura radikale të lira.

Kur radikalet e lira mblidhen, mund të krijojnë një gjendje e cila njihet si "oxidative stress". Kjo mund të dëmtojë ADN-në , dhe struktura tjera të rëndësishme të qelizave tona.

Fatkeqësisht , "oxidative stress" "stresi oksidues" kronik , mund të rrisë rrezikun e e sëmundjeve kronike si sëmundjet e zemrës, diabetit të tipit 2, dhe kancerit. (https://www.ncbi.nlm.nih.gov/pubmed/23675073)

3. (Jo e gjithë ADN-ja jonë është e përdorshme gjatë gjithë kohës. Disa gjene aktivizohen me raste, e në raste të tjera çaktivizohen – një dukuri që njihet si ekspresioni i gjeneve dhe ndikon në funksionin e qelizës. http://microbiologybook.org/Albanian/Albanian-chap9.htm)

REPUBLIKA E JEMENIT

Jemeni është një vend arab musliman, që ndodhet në jug të Gadishullit Arabik.

Emri zyrtar i këtij shteti është Republika e Jemenit dhe kryeqyteti i vendit është qyteti i San'a.

Ky vend kufizohet me Mbretërinë e Arabisë Saudite në veri, me Detin Arab dhe Gjirin e Adenit në jug, me Sulltanatin e Omanit në lindje dhe me Detin e Kuq në perëndim. Jemeni zotëron një numër ishujsh që shtrihen përgjatë brigjeve të tij në Detin e Kuq dhe Detin Arab, nga të cilët më i madhi është ishulli Saktara, që gjendet në Detin Arab, rreth 150 Km larg Jemenit. Jemeni ka një reliev të larmishëm, të përbërë nga vargmale, pllaja, fusha bregdetare si edhe zona shkretëtire.

Numri i popullsisë, sipas worldmeters, në Prill të vitit 2020, shënon 29.703.394 banorë. Sipërfaqja e vendit shkon në 527.970 km^2.

Në librat e historisë gjenden emërtime të ndryshme për Jemenin. Në kohët e lashta vendi njihej si Arabia e Lumtur. Në Teurat, Jemeni përmendet me kuptimin e tij, që do të thotë Jug dhe Mbretëria e Jugut (Mbretëria Tejemna). Ekziston edhe një mendim, që thotë se Jemeni e ka marrë emrin nga Ejmen ibn Ja'reb ibn Kahtan, pasardhës i Profetit Hud (a.s). Gjithashtu, jemenasit mendojnë se emri Jemen rrjedh nga fjala "jumn", që do të thotë begati e mirësi. Një mendim tjetër është se Jemeni mban këtë emër ngaqë ndodhet në anën e djathtë të Qabesë.

Jemeni karakterizohet nga klima e nxehtë dhe e lagësht në perimetrin bregdetar ku ka reliev fushor dhe me një klimë thuajse të moderuar përgjatë gjithë vitit. Gjatë dimrit, zonat e larta malore kanë një klimë që anon nga e ftohta. Zonat shkretinore të Jemenit karakterizohen nga klima e nxehtë dhe e thatë.

Feja zyrtare e shtetit të Jemenit është Islami, kurse gjuhë zyrtare është Gjuha Arabe.

JEMENI PËRGJATË HISTORISË

Jemeni është vendi i qytetërimeve të lashta. Atje u zhvillua qytetërimi Sebe', i cili përmendet edhe në Kur'anin Famëlartë dhe një sure e tij mban këtë emër. Populli i Sebe's, ishin nga popujt më të lashtë që njihen në Jemen. Informacione rreth tyre janë gjetur në zbulimet arkeologjike të bëra në rrënojat e qytetit të lashtë Ur, që sot ndodhet në Irak, të dhëna që datojnë njëzet e pesë shekuj para erës sonë. Sipas historianëve, populli i Sebe's i Jemenit, kanë kaluar nëpër disa faza në historinë e tyre. Në periudhën mes viteve 1300 deri në vitin 620 para erës sonë, ata njiheshin si shteti El-Ma'ije, një shtet që u zhvillua e përparoi, e që i zgjeroi kufijtë e tij deri jashtë vendeve arabe.

Më pas, nga viti 620-115 para erës sonë, ata u njohën si shteti Sebe'. Më vonë, në periudhën 115 p.e.s -300 të erës sonë, ky popull u sundua nga fisi

Himjer dhe shteti i tyre u njoh si shteti El-Himjerije i Parë, periudhë në të cilën populli i Sebeit filluan rënien e tyre, sidomos në periudhën e shtetit El-Himjerije të Dytë, që u krijua pas viti 300 e.j, kohë në të cilën vendi përjetoi shumë luftëra e konflikte, gjë e cila zgjoi lakminë e të huajve kundrejt tyre.

Duke qenë në një gjendje të dobët, vendin e pushtuan romakët, e pastaj edhe etiopianët në vitin 340 e.j. Më pas populli i Sebe's fituan pavarësinë, por në vitin 451 ndodhi Përmbytja e Madhe, ngjarje e cila përmendet edhe në Kur'an si "Sejlul-Arimi", e cila shkaktoi shkatërrimin e qyteteve dhe u dha arratinë banorëve të vendit.

Në vitin 525, në Jemen hynë sërish etiopianët dhe në vitin 549, etiopiani Ebrahe El-Eshram, e shpalli veten mbret të territoreve të Jemenit. Ky filloi të përhapte fenë e krishterë në Jemen. Ai madje ndërtoi atje një faltore si Qabeja dhe mori rrugën të rrënonte Qabenë në Mekë, histori të cilën e përmend Kur'ani Famëlartë në sSuren El-Fil (Elefanti), ku tregohet edhe përfundimi që gjeti Ebraheja në Mekë. Pas vdekjes së tij, vendin në Jemen e zunë dy bijtë e tij, të cilët ndoqën rrugën e poshtërimit të jemenasve. Kjo i shtyu jemenasit të kërkonin ndihmë nga persianët kundër etiopianëve dhe në vitin 575, ata arritën t'i përzënë etiopianët nga vendi. Megjithatë, Jemeni mbeti i pushtuar nga Persia, ku sundimtari i fundit persian aty ishte Badhani, i cili pranoi Islamin në vitin 628 e.j. Me pranimin e tij të Islamit, ndikimi i persianëve në Jemen mori fund.[2]

SI HYRI JEMENI NË ISLAM

Në kohën kur Profeti (a.s) ishte në Medine, Jemeni ishte i ndarë në komunitete fisnore si fiset Himjer, Hadremeut, Kenda dhe Hemdan. Zonat San'a dhe Aden të Jemenit ishin nën sundimin e persianëve, kurse zona e Nexhranit ishte nën ndikimin e të krishterëve romanë të Etiopisë.

Islami në Jemen nuk erdhi me një herë të vetme, as në një kohë të vetme, apo sipas një metode të vetme. Për secilën fuqi dhe secilin fis në Jemen, u ndoq një metodë e veçantë, e cila u ndoq dhe u zbatua nga i Dërguari i Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të! Si fillim, në Islam hynë individë nga fise të ndryshme të Jemenit, si Ebu Musa El Esh'arij nga fisi i Esharijve, Et'Tufejl ibn Amru nga fisi Dous dhe Kajs ibn Namt El-Hemdani nga fisi Hemdan. Secili nga këta sahabij të shquar filluan t'i ftojnë në Islam fiset e tyre.

***

Në vitin e gjashtë të Hixhretit (627 e.j), Profeti (a.s) nënshkroi me kurejshitët marrëveshjen e Hudejbijes, marrëveshje e cila siguronte armëpushim mes dy palëve. Më pas, Profeti (a.s) filloi një fushatë të gjerë thirrjesh, duke u dërguar letra mbretërve dhe prijësve të vendeve përreth.

***

Në vitin e shtatë të Hixhretit, i Dërguari i Allahut (a.s) kishte dërguar sahabiun El-Muhaxhir ibn Ebi Umeje për tek fisi Himjer, që ishte edhe fisi më i fuqishëm në Jemen, më i lashti dhe prijës përgjatë historisë së Jemenit para Islamit, që t'i thërriste në Islam. Por, ai

që do të sillte sihariqin e pranimit të Islamit nga ana e mbretërve të fisit Himjer, do të ishte sahabiu Malik ibn Merara Er'rahavij, i cili u dërgua atje në vitin e nëntë të Hixhretit, ose nga fundi i vitit të tetë.

***

Në San'a, i Dërguari i Allahut (a.s) kishte dërguar Ali ibn Ebi Talib dhe fisi Hemdan e kishin pranuar Islamin të gjithë brenda një dite.

Sahabiu El-Bera ibn Azib, i cili kishte qenë atje bashkë me Aliun (r.a), tregon: "Kur u afruam atje (tek fisi Hemdan), ata dolën e na pritën. Aliu doli përpara dhe na priu në faljen e namazit; më pas u rreshtuam sërish, dhe Aliu (r.a), doli përballë nesh dhe lexoi letrën e të Dërguarit të Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të. Menjëherë më pas, fisi Hemdan të gjithë sa ishin, deklaruan se e pranonin Islamin.

Aliu (r.a), i shkroi të Dërguarit të Allahut (a.s) për këtë lajm, dhe kur e kishte lexuar letrën, i Dërguari i Allahut (a.s) kishte bërë sexhde falënderimi, e më pas kishte thënë: Paqja qoftë mbi Hemdanin! Paqja qoftë mbi Hemdanin!" - (Buhariu)

***

Transmeton Buhariu nga Ibn Abbasi (r.a), se kur i Dërguari i Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, u kthye nga Hudejbija, në muajin Dhul Hixh'xhe të vitit të gjashtë të Hixhretit, ai u dërgoi letra mbretërve të vendeve përreth, ku i ftonte në Islam. I Dërguari i Allahut (a.s), dërgoi Abdullah ibn Hudhafe Es'sehmij për tek Kisra, mbreti i persëve, që ta ftonte në Islam dhe ia dha mesazhin e tij të shkruajtur në një letër. Abdullahu kishte treguar se kur kishte mbërritur atje, ai ia kishte dorëzuar në dorë letrën e Profetit (a.s) Kisrës. Ky i fundit kishte kërkuar t'ia lexonin dhe pasi e kishte dëgjuar, e kishte marrë letrën dhe e kishte grisur. Kur i Dërguari i Allahut (a.s) e kishte marrë vesh se si ishte përgjigjur Kisra, kishte thënë: O Zot! Grise mbretërinë e tij!

Më pas, Kisra i kishte shkruar përfaqësuesit të tij në Jemen, Badhanit, ku i thoshte të zgjidhte dy burra të tij të fuqishëm dhe t'i dërgonte tek ai burrë (Profeti, alejhi selam) që gjendet në Hixhaz (Medine), e të merrnin vesh rreth çështjes së tij.

Badhani kishte dërguar sekretarin tij edhe një tjetër me të dhe u kishte dhënë një letër për t'ia dorëzuar Profetit (a.s). Këta të dy kishin ardhur në Medinë dhe gjithë frikë ia kishin dorëzuar të Dërguarit të Allahut (a.s) letrën e

Kryeqyteti, San'a

Badhanit. I Dërguari i Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, kishte buzëqeshur dhe i kishte ftuar në Islam ata të dy. Pastaj u kishte thënë: Sot largohuni dhe ejani tek unë nesër që t'ju tregoj çfarë dua!

Ata të dy kishin ardhur të nesërmen dhe Profeti (a.s) u kishte thënë: Lajmërojeni zotërinë tuaj se Zoti im e ka vrarë zotërinë e tij, Kisrën, natën e kaluar, shatë orë pasi ka hyrë nata (ishte nata e së Martës, nata e dhjetë e muajit Xhumadi El-Ula, viti i shtatë i Hixhretit). Allahu i Lartmadhëruar i ka mundësuar të birit të tij Shirujanit (Shērōē), ta vrasë atë.

Dy burrat ishin kthyer tek Badhani me këtë lajm dhe me ta mësuar këtë, ai e kishte pranuar Islamin bashkë me bijtë e tij në Jemen."

Më pas, i Dërguari i Allahut nuk e kishte hequr nga detyra Badhanin, por e kishte lënë prijës atje, deri në fund të jetës së tij.

Me fillimin e përhapjes së Islamit në Jemen, delegacione nga të gjitha fiset e vendit kishin shkuar në Medine, njëri pas tjetrit.

Në Medine kishin shkuar edhe një delegacion nga të krishterët e Nexhranit, jo për të pranuar Islamin, por për të debatuar me të Dërguarin e Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të! Si përfundim, kishin rënë dakord të paguanin një shumë, në këmbim të jetës në paqe, nën ombrellën e shtetit Islami.

Sipas historianëve, të krishterët e Nexhranit e pranuan Islamin në shekullin e tretë të Hixhretit.

***

Nga fundi i vitit të nëntë të Hixhretit, i Dërguari i Allahut (a.s) kishte dërguar sahabiun Muadh ibn Xhebel, sahabiu më i ditur në fushën e hallallit dhe të haramit, si prijës, gjykatës dhe mësues të një zonë të gjerë të Jemenit, e cila shtrihej nga Nexhrani në veri, e deri në Aden në jug, dhe që njihej si Zona e Epërme.

Transmetohet nga Ibn Abbas (r.a), se kur i Dërguari i Allahut (a.s) e kishte dërguar sahabiun Muadh ibn Xhebel në Jemen, e kishte porositur me këto fjalë: Ti po shkon tek një popull që janë ndjekës të Librit (të krishterët e Nexhranit). Kur të shkosh atje, ftoji ata të dëshmojnë se s'ka zot tjetër, përveç Allahut dhe se Muhammedi është i Dërguari i Tij. Nëse ata të binden për këtë, tregoju se Allahu u ka bërë detyrë pesë namaze, çdo ditë dhe natë. Nëse të binden për këtë, tregoju se Allahu u ka bërë detyrë të japin sadaka, e cila merret nga të pasurit e tyre, dhe u jepet të varfërve të tyre. Nëse të binden për këtë, bëj kujdes të madh mos merr nga pasuria më e çmuar e tyre, dhe ruhu nga mallkimi i atij që i bëhet padrejtësi, sepse mes lutjes së tij dhe Allahut nuk ka perde." - (Buhariu)

Në të njëjtën kohë, i Dërguari i Allahut (a.s) e kishte dërguar edhe sahabiun e shquar, Ebu Musa El-Esharij (r.a), gjithashtu në Jemen, si prijës, gjykatës dhe mësues të Islamit atje, në atë pjesë të vendit që njihej si Zona e Poshtme. Ebu Musa El-Esharij kishte lindur në Jemen dhe atje ishte rritur, pastaj kur u shfaq Isami, ai kishte ardhur në Mekë dhe ishte bërë musliman.

Para se të shkonin në Jemen, i Dërguari i Allahut i kishte porositur të dy këto sahabe: "Lehtësoni, dhe mos vështirësoni! Përgëzoni, dhe mos frikësoni!" - (Buhariu)

***

Shumica e Jemenit hynë në Islam në periudhën mes viteve gjashtë dhe dhjetë të Hixhretit.

Kur jemenasit kishin ardhur si muslimanë tek i Dërguari i Allahut alejhi selam, ai u kishte thënë të pranishmëve: "Ja ju erdhën jemenasit. Ata janë njerëz me zemër të butë e të dhembshur. Besimi është cilësi e Jemenit (fjala "besim" në arabisht ka të njëjtën rrënjë me fjalën Jemen) dhe urtësia është cilësi e Jemenit..." - (Buhariu dhe Muslimi)

***

Sot Jemeni po kalon kohë të vështira, prandaj Allahut i lutemi të zbresë paqe në Jemen dhe t'i begatojë banorët e tij! Amin!

Përgatiti:

Msc. Arta Ujkaj, *teologe*

Burimet:

- *Es-Sira En-Nebevije fi du'el mesadir el-aslije, fq 516.*
- *https://www.islamstory.com/ar*
- *https://www.islamweb.net/ar/article*
- *http:// www.yemen-nic.info/yemen*
- *https:// www.aljazeera.net*

BESA DHE MALLI I HAXHI VEHBI GAVOÇIT

-ese-



Xhahid Bushati, *shkrimtar*

Teksa po rregulloja ca libra në bibliotekën time, papritur gjeta një zarf, ku ishte shkruar nga ana ime: "Shënime për Haxhi Vehbi Gavoçin". E kisha harruar këtë zarf, si dhe shënimet e mia, ku premtonin se një ditë (dhe kjo erdhi...) do të zgjeroheshin, do të merrnin hapësirën e një shkrimi, e njëkohësisht do të ndriçonin më tej këtë figurë mrekullijete, figura që studimet nuk duhet të pushojnë së rreshturi për të... Për modele të tilla fisnike, si Haxhi Vehbi Gavoçi që kontribuoi thekshëm në fushën e teologjisë, që kontribuoi si shkodran i mirë edhe në jetën sociale e njerëzore; e përsëris: studimet nuk duhet të heshtin...

Më pëlqen ta them, se e pata njohur në Shkodër. Aso kohe punoja në Radio Shkodra. Kur e takova, i putha dorën në fillim, dhe më pas e intervistova. E kujtoj ende atë takim që nuk zgjati më shumë se gjysmë ore. Ishte një magji! Vetë Haxhi Vehbiu ishte një magji.

MARRËDHËNIA E TIJ ME SHKODRËN ËSHTË GJENETIKE. E PATJETËRSUESHME DHE E PAHARRUESHME. NDAJ, VENDLINDJA E THËRRET. ËSHTË NJË THIRRJE E PARRESHTUR, E PANDALSHME DHE GJURMËLËNËSE.

AI VJEN E DO TË VIJË GJITHMONË NË SHKODËR... E THËRRET ZEMRA.

VJEN... SIÇ THOTË VETË: "VEÇANËRISHT... PO DU ME ARDH SE JAM PLAK E DU ME E PA PËR HERË TË FUNDIT SHQIPNIN DHE SHKODRËN...".

Tani po "bisedoj" me shënimet e mia, që nuk kanë asnjë indikacion date e kohe. Por nga mënyra e shkrimit tim, mendoj se, duhet të jenë të hershme.

1.

Në motivin e jetës së Haxhi Vehbiut, kthimet në Shkodër, në vendlindjen e tij, nuk janë pjesë legjende. Janë reale. Kanë mallin e pikëllimin njëkohësisht. Malli e pikëllimi në çdo vit moshe mbart dimension, ankth e pritje, realizime dëshire e jo ëndërr... Malli ka aromën e shtëpisë së lindjes dhe kujtimet që e bashkëshoqërojnë. Kështu që, mallin vetëm legjendat mund ta mbartin me madhështinë e përjetësinë e tyre. E sidomos mallin e Haxhi Vehbi Gavoçit!

Marrëdhënia e tij me Shkodrën është gjenetike. E patjetërsueshme dhe e paharrueshme. Ndaj, Vendlindja e thërret. Është një thirrje e parreshtur, e pandalshme dhe gjurmëlënëse.

Ai vjen e do të vijë gjithmonë në Shkodër... E thërret zemra.

Ai vjen e do të vijë gjithmonë në Shkodër. Vjen nga Xheneti...

Vjen... Siç thotë vetë: "veçanërisht... po du me ardh se jam plak e du me e pa për herë të fundit Shqipnin dhe Shkodrën...".

2.

Në shkrimet, dorëshkrimet, librat e studimet... Motivi Ballkanas shfaqet dukshëm e, përmes shprehësive e tij ka pasqyruar shumë dëlirë e pastër dashurinë midis anëtarëve të një familjeje, si: Nënë – Bir, Babë – Bir, Motër – Vëlla, Vëlla – motër, Motër – Motër, Vëlla – Vëlla, etj. Është krijuar, kështu, një koncept i veçantë i dashurisë dhe i lidhjeve që bashkon anëtarët e një shtëpie, njerëzit e një gjaku. Mendoj që në jetën e Haxhi Vehbisë kjo lidhje shndrit dhe është për t'u marrë model. Haxhi Vehbija kishte një marrëdhënie dashurie vëllazërore sa sublime aq dhe prekëse e njerëzore, me të vëllain, Haxhi Nuhin, pavarësisht se rrugët e tyre ishin të ndryshme në jetë. Haxhi Nuhi e kishte idhull Haxhi Vehbinë. Haxhi Vehbija, si pakuptuar, kishte injektuar dhe injektonte çdo ditë virtyte njerëzore dlirësie. Haxhi Nuhi i ruante si hajmali. Në jetën e tij mirësia dhe mirënjohja ishin gurë të çmuar. Të kujtojmë fjalët e Haxhi Vehbisë "Nuhi... për mua ka qenë vëlla qumështi e mishi dhe vëlla besimi..."

Gjithashtu, jeta e Haxhi Vehbisë është një pasqyrë ku reflektojnë

Haxhi Vehbi Gavoçi ishte i Besës dhe e mbarti këtë Besë deri në frymën e tij të fundit... duke lënë amanet BESËN e BESIMIT...

dashuritë e thella për prindërit, për motrën, e për vëllanë... Kjo dashuri është një besë e dhënë dhe e ngulitur në ndërgjegjen e Haxhi Vehbisë, dhe ajo shfaqet kudo, kudo... Po kujtojmë: letrat, takimet, mallin... Po kujtojmë që shtëpinë ta ketë sa më afër motrës... Po kujtojmë kur Vëllai takohet me Motrën... E ne po veçantojmë: Letrat..., të cilat janë lajmëtare të "zërave njërëzorë" siç thotë një poet.

3.

Haxhi Vehbija, krahas elekuencës dhe elegancës të integruara estetikisht bukur në shpirtin dhe sjelljen e tij, kishte dhe një fuqi mistike të fjalës; të cilat i shfaqi në xhamitë ku ai ishte i pranishëm, në Universitete të botës ku dha shumë ligjerata; në konferenca e tubime shkencore... e në bibliotekën e çmuar të librave autorialë që la pas... ("Respekti për dijen dhe librin..." – thotë Haxhi Vehbija.).

Gjithashtu nga hulumtimet tona gjejmë të shkruar: "Kush është ky njeri që të gjithë e njohin si Haxhi Vehbi Gavoçi, me çallmë e mjekër të bardhë, të qetë dhe bujar , të ditur dhe të urtë, të thjeshtë në të komunikuar me të tjerët, fisnik gjatë ecjes, të këndshëm kur buzëqesh, të përzemërt kur të flet e meditues tek sa të dëgjon?" Një model i përshkruar me vërtetësi. Njerëzor dhe hyjnor.

Por Haxhi Vehbija kishte dhe një Besë. Ajo shfaqet brenda kodit të shpirtit të tij. Kjo ishte Shkodra. Kjo është arsyeja që Ai vinte e dëshironte përherë të vinte... edhe atëhere kur mosha nuk e lejonte...

Besimi në fe, besimi te njerëzit, te qyteti i tij i Lindjes, te gurët e shtëpisë, te varret e të afërmeve, te... Kjo ishte Kënga e besës e Njeriut të besës që quhet Haxhi Vehbi Gavoçi.

Më konkretisht, ku shfaqet Besa e Tij:

1. "... e mbaj mend Babën, pastë rahmet."

2. "Më kujtohen gjithashtu mirë: "H. Sheuqet Boriçi,... H. Salih Myftia, ...".

3. "Hapat e parë të dijes i kam fillu në Shkodër, me ato pak derse që merrja nga baba,... ... Më pas në Perash tek Hafiz Hasani, Xhamia Plakë tek Hafiz Ibrahim Kruja..."

4. Besa e Mallit. "A kam mall? Po kam mall, se është vendlindja ime, aty kam kaluar fëmijërinë time, kam pasur shokët e të afërmit, por po e përsëris: Më merr malli për fetarët e mirë atje..."

5. Besa e prindërve. "Nana ka qenë si baba! Përpara te ne, nana ka qenë si pamja e dytë e babës, dmth kopja e tij! ... nana interesohej për zbatimin e urdhërave të babës. ... Atë që ai dëshironte, ajo na urdhëronte për ta bërë në jetën tonë. Gjithmonë ka qenë e pastër, n aka mësuar të jemi të tillë, me e dashtë njëri – tjetrin, me punu atë që i pëlqen Zotit (xh.sh.)."

6. Besa e nanës. "Zakonisht kur shkoja në Shkodër, qëndroja në shtëpinë e saj, ose në në ndonjë shtëpi më të gjerë dhe e shihja çdo ditë. Me raste i dërgoj letra e kujtime të ndryshme. Lum si ajo që është plakur në besim!"

Për të konkluduar: Haxhi Vehbi Gavoçi ishte dhe është kujtesë. Mosharrim!..

Haxhi Vehbi Gavoçi ishte i Besës dhe e mbarti këtë Besë deri në frymën e tij të fundit... duke lënë amanet BESËN e BESIMIT...

"LEXO ATË QË TË SHPALLET PREJ LIBRIT..."



- Osmani (r.a) ka thënë:

"Sikur të pastroheshin zemrat, ato kurrë nuk do të ngopeshin me Kur'anin".

- Ibn Tejmije ka thënë:

"Jam penduar, për humbjen e pjesës më të madhe të kohës sime në diçka tjetër, përveç kuptimeve të Kur'anit".

- Sufjan Eth-Theurij ka thënë:

"Ah, sikur të isha marrë vetëm me Kur'an!"

- Fudejl Er-Rakashi ka thënë:

Askush nuk ka shijuar dhe asnjë zemër nuk ka gëzuar me diçka, siç është zëri i bukur në këndimin e Kur'anit. Çdo zemër, që nuk e do zërin e bukur të këndimit të Kur'anit, ajo zemër është e vdekur".

- Sufjan ibn Ujejne ka thënë:

"Pasha Allahun, kurrë nuk do ta arrini kulmin e kësaj çështjeje, derisa të mos jetë asgjë më e dashur për ju, sesa Allahu. Kush e do Kur'anin, ai e do Allahun. Kuptojeni atë që ju thuhet".

- Ibnul-Kajjim ka thënë:

"Nëse dëshiron të dish çfarë ke ti dhe çfarë ka dikush tjetër, prej dashnisë së Allahut, atëherë shiko dashninë e Kur'anit në zemrën tënde".

- Katade ka thënë:

"Gjallëroni me të (Kur'an) zemrat tuja dhe gjallëroni me të (Kur'an) shtëpitë tuaja".

NE MUNDEMI!

"Kur vjen Ramazani zbuloj, se kam pasur mundësi të agjëroj çdo ditë të hëne dhe të enjte, gjatë tërë vitit dhe se agjërimi nuk është kaq i vështirë saç e kam imagjinuar. Mundem të heq dorë përfundimisht nga pirja e duhanit, por nuk jam përpjekur.

Më bëhet e qartë, se Hatmeja mujore e Kur'anit nuk është prej mrekullive, siç më bënte shejtani të iluzionoj për të.

Habitem me veten time, kur zgjohem për syfyr në Ramazan, përpara sabahut, ndërkohë e kam të pamundur të zgjohem për namazin e sabahut jashtë Ramazanit.

Më bëhet e qartë, se varfëria ekziston gjatë tërë vitit, por unë nuk e shoh, veçse në Ramazan!

Pasha Allahu, Ramazani është kurs trajnimi për të marrë një mësim të madh, e ai është: NE MUNDEMI!

O Zoti ynë, na fal për neglizhencën tonë!"



BAMIRËSIA NË RAMAZAN

Naim Drijaj,
Imam - xhamia e Parrucës

Këtë bisedë do ta ndaj në tri pjesë:

Vlera e bamirësisë.

Llojet e bamirësisë.

Frytet e bamirësisë.

1. Vlera e bamirësisë.

Allahu (xh.sh) na ka treguar në Kur'anin Famëlartë që Ai i do bamirësit: "Me të vërtetë Allahu i do bamirësit".[1] Duke bërë bamirësi ne fitojmë mëshirën e Allahut.

"S'ka dyshim se mëshira e Allahut është pranë bamirësve".[2]

"Në të vërtetë, Allahu urdhëron drejtësinë, bamirësinë dhe ndihmën për të afërmit, si dhe ndalon imoralitetin, veprat e shëmtuara dhe dhunën. Ai ju këshillon në mënyrë që ju të merrni mësim".[3]

Islami e nxit njeriun që të jetë bamirës ndaj çdo gjëje. Pejgamberi (a.s) ka thënë: "Vërtetë Allahu e ka bërë obligim mirësjelljen ndaj çdo gjëje".[4]

Abdul-Aziz ibn Mervan ka thënë: "Nëse dikush më lejon t'i bëj mirë, atëherë e mira që ai më ka bërë mua është më e madhe se sa e mira që unë ia bëj atij".

Allahu (xh.sh) i ka zbritur shpallje Ibrahimit (a.s) dhe i ka thënë: "A e di përse të kam zgjedhur mik?" Ai i është përgjigjur: "Jo" Allahu (xh.sh) i ka thënë: "Sepse kam parë që ti dëshiron më shumë të japësh sesa të marrësh."

Kur një i varfër i kërkonte Ali ibn Hasan ibn Aliut ndihmë, Aliu thoshte: "Mirë se vjen o ti, i cili po m'i bart të mirat për në botën tjetër".

Të parët tanë të mirë janë shembulli më i mirë për ne, me bujarinë dhe me bamirësinë e tyre. Për shembull, Enes ibn Sirin, çdo natë gjatë Ramazanit i ushqente pesëqind njerëz.

Sufja Eth-Theuri ka thënë: "Veprat e bamirësisë përsosen me tri cilësi: ta japësh atë sa më shpejt, ta shikosh si të vogël atë që jep (në shikimin tënd të jetë e vogël, pa marrë parasysh sa e madhe është ajo), dhe ta japësh fshehurazi".[5]

Ibn Kajimi ka thënë: "Ata që janë të mirë me robërit e Allahut, Allahu do të jetë i mirë me ta. Ata që janë të mëshirshëm ndaj tyre, Allahu do të jetë i mëshirshëm me ta. Ata që janë bujar ndaj tyre, Allahu do të jetë Bujar me ta... Allahu do t'i trajtojë robërit e Vet në këtë botë dhe në botën tjetër, sipas mënyrave që ata i trajtojnë krijesat e Tij".

Nëse dëshirojmë që të mëshirohemi atëherë duhet që të mëshirojmë të tjerët. Nëse dëshirojmë që të përkrahemi atëherë duhet që të përkrahim të tjerët.

Ibn Abasi (r.a) ka thënë: "I Dërguari i Allahut ishte shumë bujar, por Ai ishte edhe më bujar, kur takohej me Xhibrilin (a.s) në muajin e Ramazanit. Pejgamberi (a.s) ishte më bujar se retë që sillnin shiun".[6] Prandaj, shumë prej të parëve tanë përcaktonin që koha e dhënies së zekatit të tyre të ishte Ramazani, duke ditur vlerën dhe shpërblimin e madh që kanë veprat në këtë muaj.

Ez-Zuhriu, një dijetari i madh në kohën e tabi'inëve, ka thënë: "Ramazani është i karakterizuar nga leximi i Kur'anit dhe bamirësia".

2. Llojet e bamirësisë.

1. Bamirësia ndaj vetes. Bamirësia së pari fillon nga vetvetja, kjo do të thotë që secili njeri duhet t'i bëjë mirë vetes, duke e larguar veten nga punët e këqija, si p.sh: alkooli, bixhozi, imoraliteti, gënjeshtra, mashtrimi, vjedhja, përgojimi, bartja e fjalëve dhe nga çdo gjë që e hidhëron Allahun e madhëruar.

1. Kur'ani, El-Bekare: 195.
2. Kur'ani, El-Araf: 56.
3. Kur'ani, En-Nahl: 90.
4. Transmeton Muslimi.
5. Sifetu Es-Safveh, 2/169. Hiljetul-Evlija, 3/198.
6. Transmeton Buhariu dhe Muslimi.

Allahu i lartësuar ka thënë: "Vërtetë do të shpëtojë ai që e pastroi vetveten, ndërsa kushdo që e poshtëron atë (me punë të këqija), do të dështojë".[7]

2. Bamirësia ndaj prindërve. Allahu (xh.sh) ka thënë: "Zoti yt ka urdhëruar, që të mos adhuroni askënd tjetër përveç Atij dhe të silleni me bamirësi ndaj prindërve".[8] I Dërguari i Allahut (a.s) ka thënë: "Kënaqësia e Allahut është në kënaqësinë e prindërve, kurse zemërim i Allahut është në zemërimin e prindërve!".[9] Transmetohet nga Ebu Hurejra (r.a) se Pejgamberi (a.s) ka thënë: "I poshtëruar qoftë ai, të cilit i arrijnë gjallë në pleqëri prindërit e tij ose njëri prej tyre e nuk bëhen shkak prindërit (kujdesi, bamirësia ndaj tyre) për të hyrë ai në xhenet."[10]

3. Bamirësia ndaj të afërmve. Allahu (xh.sh) në Kur'an thotë: "O njerëz! Kini frikë Allahun, dhe ruajini lidhjet farefisnore...".[11] Po ashtu në një ajet tjetër Allahu i Madhëruar ka thënë: "Mbani lidhjet familjare".[12] Pejgamberi (a.s) ka thënë: "Kush beson Allahun dhe ditën e gjykimit le t'i ruajë lidhjet farefisnore".[13] Po ashtu ka thënë: "Kush dëshiron që t'i shtohet risku dhe t'i zgjatet jeta, le të ruajë lidhjet farefisnore."[14]

4. Bamirësia ndaj fqinjëve. Allahu i Madhëruar në Kur'anin Famëlartë na ka urdhëruar që të sillemi mirë me fqinjët e afërt dhe të largët.[15] Pejgamberi (a.s) ka thënë: "Xhibrili (a.s) vazhdimisht më porosiste për fqinjin, saqë mendova se do t'i japë hise në trashëgimi".[16] Nga Ebu Hurejra (r.a) transmetohet se Pejgamberi (a.s) ka thënë: "Vallahi nuk beson, Vallahi nuk beson, Vallahi nuk beson." (Sahabët) thanë: Kush O i Dërguari i Allahut? Ai tha: "Ai, prej të këqijave të të cilit nuk është i sigurt fqinji i tij".[17] Po ashtu Pejgamberi (a.s) ka thënë: "Kush beson në Allahun dhe në ditën e fundit, të mos e dëmtojë fqinjin e tij".[18] Po ashtu ka thënë: "Kush beson në Allahun dhe në ditën e fundit, le të sillet mirë me fqinjin e tij."[19]

7. Kur'ani, Esh-Shems: 9-10.
8. Kur'ani, El-Isra: 23.
9. Transmeton Tirmidhiu dhe Buhariu në Edebul-Mufred.
10. Transmeton Tirmidhiu dhe Hakimi.
11. Kur'ani, En-Nisa: 1.
12. Kur'ani, Err-Rrad: 21.
13. Transmeton Buhariu dhe Muslimi.
14. Transmeton Buhariu dhe Muslimi.
15. Kur'ani, En-Nisa: 36.
16. Transmeton Buhariu dhe Muslimi.
17. Transmeton Buhariu dhe Muslimi.
18. Transmeton Buhariu dhe Muslimi.
19. Transmeton Muslimi.

"Adhuroni Allahun dhe mos i shoqëroni Atij asgjë; silluni mirë me prindërit, të afërmit, jetimët, të varfrit, fqinjët e afërt dhe të largët, me atë që keni pranë, me udhëtarin ..."

5. Bamirësia ndaj shoqërisë. Prej llojeve të bamirësisë është edhe sjellja e mirë me shoqërinë ku jetojmë, e në veçanti ndaj këtyre kategorive që Allahu (xh.sh) i ka përmendur në këtë ajet: "Adhuroni Allahun dhe mos i shoqëroni Atij asgjë (në adhurim); silluni mirë me prindërit, të afërmit, jetimët, të varfrit, fqinjët e afërt dhe të largët, me atë që keni pranë, me udhëtarin (që ka mbetur ngushtë) dhe me ata që janë robër nën pushtetin tuaj. Në të vërtetë, Allahu nuk i do njerëzit arrogantë e mburravecë."[20] Pejgamberi (a.s) na ka nxitur që të jemi bamirës ndaj jetimëve, ku ka thënë: "Unë dhe kujdestari i jetimit do të jemi në xhenet kështu", dhe ngriti gishtin tregues dhe të madhin.[21] Po ashtu ka thënë: "A dëshiron të të zbutet zemra e të të plotësohen nevojat? Bëhu i mëshirshëm ndaj jetimit, ledhatoja kokën dhe ushqeje me atë që ushqehesh vetë; zemra do të të zbutet dhe nevoja do të të plotësohet."[22]

6. Bamirësia ndaj njerëzve në përgjithësi. Allahu i madhëruar na ka porositur që të sillemi me bamirësi edhe ndaj jomuslimanëve.[23]

3. Frytet e bamirësisë.

Frytet e bamirësisë janë të shumta por ne do të mjaftohemi me përmendjen e disa prej tyre, me shpresë që Allahu të na bëjë edhe neve prej bamirësve.

- Sa më shumë që njeriu ta shtojë bamirësinë, aq më shumë i shtohet vlera. Siç thuhet në një fjalë të urtë: Vlera e njeriut është sa bamirësia e tij.

- Bamirësit janë njerëzit më të afërt të atyre që kanë përreth.

- Bamirësia bën që pjesëtarët e një shoqërie të jenë të bashkuar dhe të lidhur me njëri-tjetrin.

- Bamirësia është mjet i ngritjes dhe përparimit të një shoqërie. Nëse drejtësia është mjet për ruajtjen e llojit njerëzor, atëherë bamirësia është mjet i ngritjes dhe përparimit të tyre.

- Bamirësia është mjet për arritjen e bereqetit në jetë, pasuri dhe familje.

- Bamirësia është mjet që i ndihmon njeriut për largimin e vetëpëlqimit, ngase bamirësia ngërthen në vetë nijetin e sinqertë.

- Bamirësia e largon armiqësinë mes njerëzve dhe e zëvendëson atë me dashuri dhe mëshirë.[24]

Këtë bisedë dua ta përfundoj me një tregim.

Në një kohë në Medine muslimanët vuanin shumë nga skamja dhe vështirësitë ekstreme. Një karvan prej 1000 devesh, i mbushur me ushqime, që i përkiste Uthmanit (r.a), shokut të Pejgamberit (a.s) arriti nga Siria në Medine. Tregtarët shkuan tek Uthmani (r.a) për t'i dhënë çmimet e tyre që t' ia blejnë mallin, por, çuditërisht sa herë që ata jepnin çmimin e tyre, Uthmani (r.a) u thoshte: "Dikush tjetër më ka dhënë çmim më të lartë sesa ju". Tregtarët ranë në hall, sepse asnjë ofertë e tyre nuk po pranohej.

Në fund, kur e dhanë edhe ofertën e tyre më të lartë, Uthmani (r.a) u tha: "Më vjen keq por dikush më ka dhënë një ofertë edhe më të lartë sesa ju. Kur e pyetën se kush është ai që u ka dhënë ofertë më të lartë sesa ne? Uthmani (r.a) u tha: Allahu më ka dhënë ofertë më të lartë sesa ju. Ai ka thënë: Se, kush jep për Mua, Unë do t'i jap atij, shumë herë më shumë se sa atë që ai e ka dhënë". Kështu ai e ndau tërë karvanin tij për hir të Allahut.[25]

I lutemi Allahut të madhëruar që të na bëjë edhe ne prej bamirësve!

20. Kur'ani, En-Nisa: 36.
21. Transmeton Buhariu.
22. Shejh Albani në librin e tij Sahih el-Xhami, e ka klasifikuar të saktë.
23. Për më shumë shih ajetin, 13 të sures El-Maide.
24. Shkëputur me disa ndryshime nga libri Nedretun-Neim, 2/91.
25. Shkëputur nga libri "Ahlakuna el-Ixhtima'ijeh" Mustafa Sibai'i, fq. 21.

XHAMIA NË BARDHAJ BËHET GATI PËR MUAJIN E BEGATË TË RAMAZANIT

Prej një muaji, besimtarët e xhamisë së fshatit Bardhaj, me në krye imamin e tyre, H. Ilir Dizdari, këshillin e xhamisë dhe bamirësit në mes tyre, janë angazhuar maksimalisht në drejtim të mirëmbajtjes së xhamisë, duke nisur me pastrimin e saj sistematik, lyerjen e ambienteve të brendshme, ndërrimin e tapetit, sistemimin e oborrit, përsosjen e sistemit të ndriçimit nga brenda dhe jashtë, etj.

Krejt kjo punë e mbarë vjen si pjesë e përgatitjeve të xhamisë në pritje të Muajit të Begatë të Ramazanit.

Pavarësisht gjendjes së krijuar pas përhapjes së pandemisë së re, mesazhet që vijnë nga xhamia e fshatit Bardhaj, dhurojnë shpresë e optimizëm, jetë e gjallëri, për të cilat kemi shumë nevojë sot, për të mundur frikën, ankthin e stresin, që përhap ditë pas dite propaganda e mbrapshtë e shpërndarjes së panikut ndër njerëz.

Myftinia Shkodër falënderon përkushtimin e madh të besimtarëve muslimanë në Bardhaj, sidomos në këto ditë dhe në veçanti për këtë përkushtim të madh ndaj xhamisë, që mbetet pikë referimi për jetën tonë!

NIS CIKLI I RI I LIGJËRATAVE: "NË PRITJE TË RAMAZANIT 1441"

Ditën e hënë, më 13 prill 2020, nisi cikli i ri i ligjëratave online: "Në pritje të Ramazanit 1441", që organizon Myftinia Shkodër në kuadër të aktiviteteve dhe ligjëratave në prag të Muajit Ramazan.

Sipas programit të ri, gjatë periudhës 13-23 prill 2020, çdo ditë në orën 10.00, nëpërmjet profilit zyrtar të Myftinisë Shkodrës në fb, do të mund të ndiqni ligjërata e përgatitura nga imamët tanë të nderuar.

Ndërkohë, ditën e xhuma, në orën 13.00, do të mund të ndiqni mesazhin e ditës së xhuma nga Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari.

Cikli i ri i ligjëratave është një mundësi e mirë për të mësuar edhe më shumë rreth agjërimit të Muajit Ramazan, vlerave dhe dobive të tij.

Sipas kalendarit të këtij viti, që do të shpërndahet për të gjithë të interesuarit gjatë ditëve në vijim, nata e parë e teravisë është ditën e enjte, më 23 prill 2020, ndërkohë dita e parë e agjërimit të Muajit Ramazan 1441 është të xhumanë, më 24 prill 2020.

CIKLI I LIGJËRATAVE ONLINE

ÇDO DITË, ORA: 10.00
E XHUMA, ORA: 13.00

"NË PRITJE TË RAMAZANIT 1441" - (13-23/4/2020)

DATA	LIGJËRUESI	TEMA
E Hënë 13.4.2020	*H. Lavdrim Hamja*	Ramazani, muaji i paqtimit me Zotin
E Martë 14.4.2020	*H. Ervil Kuçi*	Ramazani, muaji i mëshirës
E Mërkurë 15.4.2020	*H. Naim Drijaj*	Bamirësia në Ramazan
E Enjte 16.4.2020	*H. Durim Kasemi*	Ramazani, muaj i shëndetit
E Xhuma 17.4.2020	*Imam Muhamed B. Sytari*	Mesazhi i xhumasë
E Shtunë 18.4.2020	*H. Adem Pizga*	Agjërimi tek të parët tanë
E Diel 19.4.2020	*H. Bashkim Bajraktari*	Ramazani, muaji i Kur'anit
E Hënë 20.4.2020	*H. Idmir Plaku*	Hadithe mbi vlerën e Ramazanit
E Martë 21.4.2020	*H. Ardit Hoxha*	Ramazani, muaj i virtytit
E Mërkurë 22.4.2020	*H. Arben Halluni*	"Që të bëheni të devotshëm..."
E Enjte 23.4.2020	*Imam Muhamed B. Sytari*	Mesazhi i Ramazanit

UDHËZIMI DHE DRITA E ZOTIT NA NDRIÇOFSHIN JETËN!

(Mesazh urimi për komunitetet e krishtera të Shkodrës, në kushtet e pamundësisë së zhvillimit të vizitave dhe urimeve tradicionale, për shkak të rregullave të imponuara nga e quajtura pandemi covid 19)

Të nderuar drejtues të bashkësive të krishtera të zonës Shkodër, katolikë dhe ortodoksë, respektivisht, Mons. Angjelo Masafra dhe At Aleksandër Petani!

Të dashur bashkëqytetarë të besimeve të krishtera në Shkodër!

Zoti i gjithësisë desht për ne që të jetojmë së bashku në këtë nënqiell të këtij qyteti të begatë, plot mirësi e bekim, duke marrë e dhënë në harmoni me vlerat tona fetare, qytetare e kombëtare, në përpjekje të vazhdueshme për të ruajtur ekuilibrin e natyrës dhe dritën e paqes, si dëshmitar të tyre, si përhapës e mbrojtës me dinjitet të një obligimi të shenjtë, që buron nga Fjala e Zotit të gjithësisë: "O ju njerëz, vërtet Ne ju krijuam juve prej një mashkulli dhe një femre, ju bëmë popuj e fise që të njiheni ndërmjet vete, e s'ka dyshim se te All-llahu, më i fisniku ndër ju është ai që më tepër është ruajtur (nga të këqijat), e All-llahu është shumë i dijshëm dhe hollësisht i njohur për çdo gjë!" – (Kur'ani, El-Huxhurat: 13).

Ai na udhëzoi drejt vlerave të harmonisë dhe respektimit të ndërsjellët, duke na treguar nëpërmjet teksteve të shenjta se, njeriu është vëlla i njeriut dhe se, më i dobishmi i tyre për vëllezërit e tij, është më i dashuri i tyre për Krijuesin e gjithësisë, siç na mëson i Dërguari i fundit i Zotit të gjithësisë, Hz. Muhammedi (a.s.).

Nga këtu, më lejoni që në këtë ditë të shënuar për ju, të lutem me zemër që drita e Zotit të ndriçojë jetën tuaj, të keni paqe e bekim, për të shijuar nëpërmjet tyre mirësinë e mëshirës së Krijuesit, kur ajo depërton në zemrën dhe jetën e robit të Tij!

Kushtet e imponuara na ndalojnë takimin fizik dhe urimet nga afër, mirëpo kjo nuk pengon që mesazhet tona të kapërcejnë pengesat materiale, duke u dëshmuar si shenja drite, harmonie njerëzore, si dhe përpjekje të pandërprera për të mirën e paqes sociale, mirëkuptimit e vëllazërisë kombëtare, për të cilën jemi të angazhuar të punojmë e të shërbejmë me sa të kemi forcë e jetë!

Të gjithë së bashku, le të lutemi që kjo situatë jashtë vullnetit tonë, të na shërbejë për t'u kthyer me bindje e shpirt nga dera e madhe e besimit, afrimit me dashninë e Zotit dhe bashkëpunimit tonë për të mirën e qytetit, vendit dhe njerëzimit!

Ju uroj çdo të mirë dhe lutem për ju!

Imam Muhamed B. Sytari
Myfti i Zonës Shkodër
Shkodër, më 12 prill 2020

MYFTINIA SHKODËR NDIHMON FAMILJEN MATAJ

Paraditen e xhuma, më 17 prill 2020, Myftinia Shkodër i është përgjigjur thirrjes për ndihmë të familjes Mataj, në lagjen Drobraç.

Përfaqësuesi i Myftinisë Shkodër, teologu Lavdrim Hamja, u shpreh se, pas kronikës në televizionin lokal, Star Plus, për ndihmë të kësaj familjeje, menjëherë u përgjigjem duke sjellë disa ndihma ushqimore.

"Sot është ditë e xhuma dhe për myslimanët është ditë feste, por edhe në prag të ardhjes së muajit të begatë të Ramazanit, Myftinia Shkodër përmes bashkëpunimeve me shoqata dhe institucione, por dhe me bamirës të ndryshëm, po jep kontributin e saj në lehtësimin e vështirësive dhe halleve që njerëzit po kalojnë në këtë kohë të pandemisë" – tha teologu Hamja.

Gjatë kësaj periudhe të pandemisë Covid-19, Myftinia Shkodër ka qenë në ndihmë të familjeve në nevojë duke shpërndarë rreth 200 pako ushqimore për njerëzit në nevojë.

Myftinia Shkodër u bën thirrje biznesmenëve dhe gjithë atyre që kanë mundësi të kontribuojnë për familjet në nevojë, të mos kursejnë kontributin e tyre, sepse Zoti i Madhëruar i shpërblen shumëfish bamirësit dhe ata që ndihmojnë të varfrit dhe të vobektët.

MYFTINIA SHKODËR NË PRAG TË RAMAZANIT SHPËRNDAN 60 PAKO MË NDIHMA USHQIMORE

Të hënën, më 20 prill 2020, në prag të muajit të madhëruar të Ramazanit, Myftinia Shkodër në sajë të mbështetjes nga institucionet partnere të saj, brenda dhe jashtë vendit, ka organizuar projektin e shpërndarjes së ndihmave me pako ushqimore për 60 familje në nevojë.

Përfaqësuesi i Myftinisë, teologu Arben Halluni në fjalën e tij para medieve tha se: "Këto ndihma vijnë si përgjigje e thirrjes së Allahut (xh.sh), që në këto situata që po kalon vendi ynë dhe mbarë bota, si shkak i pandemisë globale të koronavirusit si dhe në vigjilje të muajit më të mirë islam, Ramazani, të ofrojmë solidaritetin dhe kontributin tonë ndaj shtresave në nevojë, të varfëra, të vetmuarve etj".

Teologu Halluni tha se: "Nëse jemi të këshilluar më të drejtë nga institucionet e vendit që të bëjmë distancim social dhe fizik, kjo nuk do të thotë që të bëjmë distancim shpirtëror dhe human ndaj të vobektëve dhe nevojtarëve".

Në fund ai i bëri thirrje biznesmenëve që të afrohen dhe të kontribuojnë edhe ata sidomos gjatë muajit të begatë të Ramazanit si dhe uroj të gjithë besimtarët për agjërim të lehtë dhe të pranuar nga Zoti Fuqiplotë.

Myftinia Shkodër në ditët në vijim do të vazhdojë me projekte të tjera bamirëse për shtresat e varfra në mënyrë që t'i lehtësohet sado pak situata e tyre e vështirë ekonomike dhe sociale.

VAZHDON PUNA PËR PASTRIMIN DHE RRETHIMIN E VAKËFIT TE FUSHA E TABAKUT

Ditën e martë, më 21 prill 2020, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, inspektoi në terren punën që po bëhet prej disa ditësh, për pastrimin dhe rrethimin e vakëfit te fusha e Tabakut, bri xhamisë së Plumbit.

Myftiu falënderoi përgjegjësin dhe kujdestarin e këtij vakëfi, z. Abdullah Myftija, që me përkushtim të madh ka organizuar banorët e zonës për të realizuar këtë shërbim me vlerë për komunitetin.

Prej disa kohësh, Myftinia Shkodër ka arritur që të kthejë në identitet vakëfet e zaptuara te xhamia e vjetër e Qafës, si dhe vakëfin e xhamisë së Tabakut, ku akoma sot shihen qartë gjurmët e këtyre dy xhamive të vogla të lagjes së Tabakut, në hapësirat e xhamisë së Plumbit.

PEJGAMBERI (A.S) KA THËNË:

"Pasha Allahun, me të vërtetë Allahu nuk mërzitet prej jush, derisa ju të mërziteni prej Tij", puna më e dashur për Pejgamberin (a.s) ka qenë, ajo të cilën njeriu e vepronte përgjithmonë."

(BUHARIU DHE MUSLIMI)

MYFTIU: "MUAJI I RAMAZANIT, MUAJ I VËLLAZËRISË DHE HARMONISË NË MESIN E NJERËZVE!"

Mbrëmjen e së martës, më 28 prill 2020, nëpërmjet ligjëratës së prag iftarit, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, theksoi se Muaji i Ramazanit është edhe muaj i forcimit të vëllazërisë në mesin e besimtarëve muslimanë dhe e shtimit të harmonisë në mesin e njerëzve në përgjithësi.

Me këtë rast, ai përcolli edhe një mesazh të rëndësishëm që lidhet me vlerat e harmonisë fetare në Shkodër, edhe në këtë atmosferë të begatë të Muajit Ramazan.

"Prej shenjave të mirësisë së Ramazanit, bekimeve hyjnore dhe sakrificave në këtë muaj të madhërishëm është edhe shfaqja e shenjave të vëllazërisë dhe unitetit mes njëri-tjetrit.

A ka diçka më të bukur sesa të shohësh njerëzit duke uruar njëri-tjetrin? Për shembull, kam vënë re, se në Shkodër ku bashkëjetojnë në harmoni muslimanë dhe të krishterë, inshallah, sa herë ka festa të komuniteteve fetare, besimtarët urojnë njëri-tjetrin, miqtë, shokët, bashkëpunëtorët, komshinjtë, etj. Muslimanët urojnë besimtarët e krishterë dhe të krishterët urojnë besimtarët muslimanë.

Këtë e kemi vënë re tani, edhe në harkun e dy-tre javëve të fundit, ku të tre komunitetet fetare kanë qenë të përfshira në një atmosferë të begatë me festa dhe ngjarje të shënuara në secilën prej besimeve.

Kemi parë se përhapja e frymës së harmonisë dhe vëllazërisë mes njerëzve ka qenë e dëshmuar dhe kjo është një mirësi e madhe, sepse përtej diversitetit, forca e besimit dhe elementët e përbashkët që nxisin bashkëpunimin dhe respektin e ndërsjellët, dominojnë dhe bëhen shkak për një dobi të madhe në komunitet.

Nga këtu them se kushdo që nxit harmoninë në mesin e njerëzve, duke e pranuar tjetrin e duke respektuar shenjtëritë e tij dhe përkatësinë fetare, duhet respektuar dhe nderuar!

Sot, pamë përshëndetjen e Kardinal Ernest Troshanit, i cili pavarësisht se jashtë vendit dhe jo në Shkodër, porse kishte një urim të përzemërt për ne myslimanët dhe kjo është diçka për t'u vlerësuar.

Duhet të kuptojmë dhe të vlerësojmë se muaji i Ramazanit është muaji i vëllazërisë në mesin e besimtarëve, si dhe nxitës i harmonisë në komunitet!", – tha ndër të tjera Myftiu.

AMBASADA E KUVAJTIT NDIHMON 150 FAMILJE SHKODRANE

Në atmosferën e begatë të Muajit Ramazan, si dhe në kushtet e vështirësisë ekonomike, si pasojë e përkufizimeve drastike, për shkak të pandemisë Covid 19, ambasada e Shtetit të Kuvajtit në Tiranë, ka sjellë ditën e mërkurë, më 29 prill 2020, 150 pako ushqimore për njerëzit në nevojë.

Si një traditë e përvitshme bujare, në ditët e muajit Ramazan, ajo i është dorëzuar Myftinisë Shkodër, me ç'rast ka nisur edhe shpërndarja e këtij amaneti nga vëllezërit bamirës në Shtetin e Kuvajtit.

I pranishëm në vendin e shpërndarjes së këtyre ndihmave ishte edhe Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, që dha edhe një mesazh falënderimi në prani të mediave lokale.

Myftiu falënderoi kontributet e vyera të shtetit të Kuvajtit dhe institucioneve të tij bamirëse, si dhe vlerësoi se kjo ndihmë bujare përkon edhe me gjendjen e rënduar ekonomike të njerëzve për shkak të situatës që po kalojmë.

Myftiu, shprehu një falënderim edhe për drejtuesin e Fondacionit "Mirësia", z. Korab Kaja, i pranishëm në këtë aktivitet bamirës.

Nga ana e tij, edhe z. Kaja falënderoi bamirësitë e Shtetit të Kuvajtit dhe theksoi se nëpërmjet fondacionit që ai drejton, po shpërndahen me mijëra ndihma ushqimore për nevojtarët e shumtë në të gjithë vendin.

Ditën e sotme, u shpërndanë ndihma ushqimore për familje në nevojë edhe në fshatrat Bardhaj, Bushat, Mjedë e Shirq.

Myftinia Shkodër do të vazhdojë të jetë në ndihmë të njerëzve në nevojë edhe përgjatë ditëve në vijim të muajit të begatë të Ramazanit.

Me zemër të mirë Muajin e Ramazanit!

I DËRGUARI I ALL-LLAHUT (A.S) KA THËNË:

"Ju erdhi Ramazani, muaji i begatisë.

Ju mëshiron All-llahu në të, duke ju fshirë me mëshirën e Tij gabimet dhe duke iu përgjigjur lutjeve tuaja.

All-llahu shikon në adhurimin tuaj dhe mburret me ju para melekëve.

Tregoni pra, All-llahut, nga vetja juaj vetëm të mira.

I ngratë është vetëm ai, që s'e meriton mëshirën e All-llahut në këtë muaj!"

- Transmetuar nga Tabaraniu -

RAMAZAN 1441 PRILL/MAJ 2020

	E XHUMA	E SHTUNË	E DIEL	E HËNË	E MARTË	E MËRKURË	E ENJTE
RAMAZAN - PRILL	24 Syfyri 04:02 Dielli 05:45 Dreka 12:48 Iqindija 16:34 **Iftari 19:38** Teravia 21:10 **1**	25 Syfyri 04:00 Dielli 05:44 Dreka 12:48 Iqindija 16:34 **Iftari 19:39** Teravia 21:11 **2**	26 Syfyri 03:58 Dielli 05:42 Dreka 12:48 Iqindija 16:34 **Iftari 19:41** Teravia 21:13 **3**	27 Syfyri 03:57 Dielli 05:41 Dreka 12:47 Iqindija 16:35 **Iftari 19:42** Teravia 21:14 **4**	28 Syfyri 03:55 Dielli 05:40 Dreka 12:47 Iqindija 16:35 **Iftari 19:43** Teravia 21:16 **5**	29 Syfyri 03:53 Dielli 05:38 Dreka 12:47 Iqindija 16:35 **Iftari 19:44** Teravia 21:17 **6**	30 Syfyri 03:51 Dielli 05:37 Dreka 12:47 Iqindija 16:35 **Iftari 19:45** Teravia 21:19 **7**
RAMAZAN - MAJ	1 Syfyri 03:49 Dielli 05:36 Dreka 12:47 Iqindija 16:36 **Iftari 19:46** Teravia 21:20 **8**	2 Syfyri 03:47 Dielli 05:34 Dreka 12:47 Iqindija 16:36 **Iftari 19:47** Teravia 21:22 **9**	3 Syfyri 03:45 Dielli 05:33 Dreka 12:47 Iqindija 16:36 **Iftari 19:48** Teravia 21:24 **10**	4 Syfyri 03:44 Dielli 05:32 Dreka 12:47 Iqindija 16:37 **Iftari 19:49** Teravia 21:25 **11**	5 Syfyri 03:42 Dielli 05:31 Dreka 12:46 Iqindija 16:37 **Iftari 19:50** Teravia 21:27 **12**	6 Syfyri 03:40 Dielli 05:29 Dreka 12:46 Iqindija 16:37 **Iftari 19:51** Teravia 21:28 **13**	7 Syfyri 03:38 Dielli 05:28 Dreka 12:46 Iqindija 16:38 **Iftari 19:52** Teravia 21:30 **14**
RAMAZAN - MAJ	8 Syfyri 03:37 Dielli 05:27 Dreka 12:46 Iqindija 16:38 **Iftari 19:53** Teravia 21:31 **15**	9 Syfyri 03:35 Dielli 05:26 Dreka 12:46 Iqindija 16:38 **Iftari 19:54** Teravia 21:33 **16**	10 Syfyri 03:33 Dielli 05:25 Dreka 12:46 Iqindija 16:38 **Iftari 19:55** Teravia 21:34 **17**	11 Syfyri 03:32 Dielli 05:24 Dreka 12:46 Iqindija 16:39 **Iftari 19:56** Teravia 21:36 **18**	12 Syfyri 03:30 Dielli 05:23 Dreka 12:46 Iqindija 16:39 **Iftari 19:57** Teravia 21:37 **19**	13 Syfyri 03:28 Dielli 05:21 Dreka 12:46 Iqindija 16:39 **Iftari 19:58** Teravia 21:39 **20**	14 Syfyri 03:27 Dielli 05:20 Dreka 12:46 Iqindija 16:40 **Iftari 19:59** Teravia 21:40 **21**
RAMAZAN - MAJ	15 Syfyri 03:25 Dielli 05:19 Dreka 12:46 Iqindija 16:40 **Iftari 20:00** Teravia 21:42 **22**	16 Syfyri 03:23 Dielli 05:19 Dreka 12:46 Iqindija 16:40 **Iftari 20:01** Teravia 21:44 **23**	17 Syfyri 03:22 Dielli 05:18 Dreka 12:46 Iqindija 16:41 **Iftari 20:02** Teravia 21:45 **24**	18 Syfyri 03:20 Dielli 05:17 Dreka 12:46 Iqindija 16:41 **Iftari 20:03** Teravia 21:47 **25**	19 Syfyri 03:19 Dielli 05:16 Dreka 12:46 Iqindija 16:41 **Iftari 20:04** Teravia 21:48 **26**	20 Syfyri 03:18 Dielli 05:15 Dreka 12:46 Iqindija 16:41 **Iftari 20:05** Teravia 21:50 **27**	21 Syfyri 03:16 Dielli 05:14 Dreka 12:46 Iqindija 16:42 **Iftari 20:06** Teravia 21:51 **28**
RAMAZAN - MAJ	22 Syfyri 03:15 Dielli 05:13 Dreka 12:46 Iqindija 16:42 **Iftari 20:07** Teravia 21:52 **29**	23 Syfyri 03:13 Dielli 05:13 Dreka 12:46 Iqindija 16:42 **Iftari 20:08** Teravia 21:54 **30**	24 FITËR BAJRAMI **1** Shevval				

19.05.2020 (e martë) - **NATA E KADRIT**

24.5.2020 (e diel) - DITA E PARË E FITËR BAJRAMIT.

BAJRAMI FALET NË ORËN 06:00

Oraret janë referuar zonës së Shkodrës

Botues:
Myftinia Shkodër
Drejtues:
Imam Muhamed Sytari

Kryeredaktor:
Lavdrim Hamja

Tel / Fax:
+355 (0) 224 2081
Nr. llogarie:
100054 UBA - Shkodër

MYFTINIASHKODER1990
udhaislame@myftinia-shkoder.org
www.myftinia-shkoder.org

Çmimi: 50 lek